

# VLERË

REVISTË PËR FAMILJE DHE SHOQËRI



Drejtësia  
nuk ekziston

faqe 2

Këshilla martesore

faqe 23

Si ta ndërtoj  
**karakterin tim**

**Emrat e Zotit**  
bëjnë mrekulli

faqe 20

# DREJTËSIA NUK EKZISTON



Ikballe Berisha Huduti

Është shumë e mahnitshme fuqia e njeriut të cilit i bëhen padrejtësitë, e kur ai e sheh veten me të drejtën. Shpesh herë miqtë dhe familjarët e mi, më thonë; "Mos beso në drejtësi, se nuk ka drejtësi në Kosovë." O mik, o burri im, o bija

ime, o bijtë e mi, e di që drejtësi nuk ekziston, as sot as në kohën e Profetit dhe kur s'do të ketë drejtësi gjersa ne nuk e ngrisim zérin tonë kundër padrejtësisë. Gjithmonë do të ketë padrejtësi gjersa ju nuk e përkrahni me trimëri drejtësinë. A nuk ja kam treguar se as në kohën e Fatimës bijës së vetme të pporfeti Muhamed paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij, menjëherë pas shehadetit (vdekjes) së babit të saj, Fatime Zehra a shumë u torturua sa që deri në vdekje u gjakua, ajo kërkoi drejtësi me fëmijën e saj të plagosur në bark, ajo vrapi për në xhami për të kërkuar drejtësi. Kush ishte Fatimeja e kush jam unë, o njërz më kuptioni pash hz. Muhamedin. Pse të kërkojë nga dikush të ma servoj drejtësinë kur unë nuk kërkojë drejtësi, kur unë nuk e ngrisë zérin tim kundër padrejtësisë."

Fatimja ishte vajza e Profetit, asaj ju bënë padrejtësi më shumë se çdo femre tjeter në botë, por ajo çfarë bëri, a ndenji duar kryq si ti e të tjerët, si ju qe vetëm përsërisni si qyqarë dhe më zbehni mendimin dhe guximin duke thënë "nuk ka drejtësi". Edhe në kohën e Fatimes nuk kishte drejtësi, edhe pse ende aroma e Profetit Muhamed ndihej në xhami. Por Fatimja çfarë bëri, a ndenji me të padrejtit apo iu bashku të drejtës? Me siguri se Fatimja bëri atë çfarë asnje grua në botë nuk e bëri. Fatimja në ditët e fundit të jetës së saj e ndërtói së bashku me Imam Aliun Kasollen e Vajtimiit në varrezat Baki ku babai i saj ishte varrosur pesëdhjetë ditë më parë. Ajo çdo ditë të jetës së saj pas vdekjes së babait e kaloi në këtë Kasolle të Vajtimit, duke vajtar dhe duke ia numëruar të bëmat e miqve të Pejgamberit paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij. Ajo tha, ajo iu ankua babait mbi trupin e freskët me tokë të mbuluar. Fjalët e saja jehoni në tërë qytetin e bekuar:

**"Dëgjo o Baba çfarë është duke përjetuar vajza jote Fatime Zehra (Fatimja e Ndritur) që tani po zhytet në lotët e vajtimit duke e ngritur zérin kundër padrejtësisë që ia bënë bijës sate të vetme që ti u gëzove për ditëlindjen time o Baba, e që Zoti me suren Kevther të përuroj për në lindje time të bekuar, ndërsa unë tani po dënes, po vajtojë, po gjëmoj, jo për dhimbjet dhe plagët se të gjitha i durojë o Baba, por dua që padrejtësia ndaj meje le të jehojë, e mos vallë miqtë e tu do të ndërgjegjësohen dhe pendim tek Zoti të kërkojnë. O Baba miqtë e tu kanë harruar që duart e mia mi ke ledhatuar, fytyrën më ke puthur e tani kjo fytyrë po lahet me lotët e padrejtësisë të poshtëruar. "**

Unë pasi ia thash këto fjalë bashkëshortit tim, u mbusha me vajë edhe ai gjithashtu u lëndua shumë që më bëri të ndihem keq, por të kundërtën unë u ndjeva shumë mirë sepse arrita ta bind bashkëshortin tim se drejtësia duhet kërkuar e jo ta justifikojmë veten " se nuk ka drejtësi".

Që nga ajo ditë, as bashkëshorti, as bija, as bijtë e mi, as miqtë e mi që më akuzoni pse kërkova drejtësi, më asnjë fjalë kurrë ne jetë nuk më thanë se nuk ka drejtësi. Falëm o Zot mua dhe të gjithë ata që padrejtësi më kanë punuar.

*E shkruajta: 20 Mars 2020 në shtëpinë time gjatë arrestit shtëpiak.*



# Lidere më thonë, por.....

Unë jam lidere e mendimeve të mia  
Fjalët dhe fjalitë janë ushtarët e mi  
Ata nuk mbysin, nuk vrasin nuk helmojnë  
Por pa ndarë PARAGRAFE krijojnë

Parafrafët e mi janë, komandant e rreshter  
Gjeneral, ushtarë e njerëz me nder  
Rrinë të armatosur të gatshëm përgjithmonë  
Me fishek të panjohur që emrin SHKRONJA e kanë

Këto shkronja fisheku askënd se lëndoijnë  
As gjurmë as plagë, as gjak nuk rrjedhojnë  
Por zemrat e lënduara me dashuri i ngushëllojnë  
E njerëzit e pandërgjegjshëm .....!  
( Pasi të kryej gjykimin, atëherë do ta vendos edhe fjalën e mbetur në fyt)

*Qendra e Paraburgimit*

*Burgu i Grave në Lipjan*

**KOSOVË**

*10/01/2020 Ora; 20:30*

# *Cfarë është Islami?*

*"Po e cilësoj islamin  
sic nuk e ka cilësuar asnjëri para meje.  
Islami është përkushtim,  
përkushtimi është bindje e fortë,  
bindja e fortë është pranim,  
pranimi është pohim,  
po himi është zbatimi,  
kurse zbatimi është vepër."*

Imam Aliu - paqja qoftë mbi të

# Këshilla nga Pejgamberi

(paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij)

## Prifti dhe Profeti Muhamed

Tani do të përmendim disa pjesë të një hadithi të gjatë, ku përmendet një prift i krishterë që i parashtron shumë pyetje të Derguarit të Allahut s.a.a. në lidhje me fenë Islame dhe në fund bëhet Mysliman. Ky prift quhej Shem'un ibn Lavi dhe ishte pasardhës i një havariuni të Isës (a.s.) me emrin Jahuda, i cili ishte mjaft i njojur në kohën e Hz Resulullahut (s.a.a.).

## Çka është mendja?

Shem'uni e pyet Resulullahun s.a.a :

- "Më jep njojuri në lidhje me mendjen. Çka është mendja? Çfarë është ajo? Cilat janë produktet e mendjes? Më shpjegoni të gjitha detajet në lidhje me këtë?"
- Resulullahu (s.a.a.) iu përgjigji: "Mendja është pranga e paditurisë. Nefsi (egoja) i përngjan shtazës më të keqe; nëse nuk prangoset, ai do të lazdrohet. Allahu e krijoj mendjen dhe i urdhëroi atij "Afrohu", dhe ai u afrou. Pastaj i tha: "Kthehu" dhe ai u kthye. Më pastaj, Allahu Teala urdhëroi në këtë mënyrë: "Betohem në madhërinë dhe lartësinë Time, nuk kam krijuar asgjë më të dégjueshëm as më të mrekullueshëm se ti; me ty do ta fillojë krijimin dhe me ty do ta përtërijë atë. Shpërblimi do të jetë për ty dhe dënimini do të jetë për ty" (Sepse, ai që nuk ka mend nuk do të japë llogari para Allahut).

Pastaj, vazhdoi me ndërlidhjet në këtë mënyrë: Prej mendjes, rrjedh pjekuria, prej pjekurisë, dituria, prej diturisë, maturia, prej maturisë, ndershmëria, prej ndershmërisë, të ruajturit e vetes, prej të ruajturit të vetes, turpi, prej turpit, serioziteti, prej seriozitetit, rrjedh vazhdimësia e punëve të mbara, prej vazhdimësisë së punëve të mbara, rrjedh urrejtja për të këqijat dhe prej urrejtjes për të këqijat, u nda bindja ndaj atij që këshillon. Këto janë dhjetë produktet e së mbarës që rrjedhin nga mendja. Çdonjëra prej tyre ndahet në dhjetë nënprodukte tjera.

## Produktet e pjekurisë

Produktet e pjekurisë janë: Sjellja e mirë, shoqërimi me njerëzit e mirë, largimi nga poshtërimi, largimi nga sjelljet e ulëta, dëshira e madhe për mirësi, afrimi te shkallët e larta, falja e të tjerëve, të jetuarit mirë, dhënia e dhuratave dhe mosshqiptimi i fjalëve të kota.

Mendjes

RRJEDH

Pjekuria

RRJEDH

Dituria

RRJEDH

Maturia

RRJEDH

Ndershmëria

RRJEDH

Të ruajturit të vetes

RRJEDH

Turpi

RRJEDH

Serioziteti

RRJEDH

Vazhdimësi a  
e punëve të mbara

RRJEDH

Urrejtja  
për të këqijat

## Produktet e diturisë

Produktet e diturisë janë: Pasuria krahas varfërisë (ta shohësh vetveten të pasur nëpërmes diturisë); bujaria (xhymerc), krahas koprracisë (njeriu mund të jetë ko-

prrac nga vetvetja, por nëpërmes diturisë bëhet bujar); të qenët madhështor, krahas thjeshtësisë; të qenët i shëndoshë, krahas sëmundjes (edhe nëse trupin e ka të sëmurë, moralin e ka në vend); të qenët afër, krahas largësisë; të qenët i turpshëm, krahas insistimit dhe inatit; lartësimi krahas përbuzjes; ndershëmëria krahas péruljës; të fituarit e urtësisë, respektit dhe pozitës. Këto janë gjërat që mund të përfiton përmes diturisë së mendjes. Atëherë, lum për atë që mund të bëhet dijetar dhe i mençur.

## *Produktet e maturisë*

Produktet e maturisë janë: E vërteta, udhëzimi në rrugën e drejtë, bamirësia, devotshmëria, arritja e suksesit, përbajtja e vetes, të qenët ekonomik në jetë, shpérblimi, fisnikeria dhe njohuria përfshirë e Allahut. Këto janë gjërat që përvetësohen përmes pjekurisë. Atëherë, i lumtë atij që është i qëndrueshëm në këtë rrugë.

## *Produktet e ndershëmërisë*

Produktet e ndershëmërisë janë: Pajtimi me fatin, modestia, përfitimi nga të mirat, qetësia e brendshme, interesimi për gjendjen e atyre që janë nën kujdesin tënd, natyra e turpshme, përmendja (të qenët i vëmendshëm), përkujtimi, dhënia e dhuratave dhe të qenët xhymert. Këto janë gjërat që i përfiton zotëruesi i mendjes përmes ndershëmërisë dhe të të treguarit të kënaqësisë përfshirë e dhënë nga ana e Allahut.

## *Produktet e ruajtje*

### *së vetes*

Produktet e ruajtjes së vetes janë: Qetësimi (rehatia), përulja, asketizmi, pendimi, mirëkuptimi, edukata, dhurimi, fitimi i simpatisë, kryerja e punëve të mbarës dhe largimi nga të këqijat. Këto i përfiton zotëruesi i mendjes nëse ruhet prej mëkateve. Atëherë, lum për atë që ruhen.

## *Produktet e ruajtjes së vetes*

Produktet turpit janë: Natyra e butë, ndjeshmëria, të ruajturit nga Allahu, haptas dhe fshehtas, korrekësia, ruajtja nga të këqijat, ftyra e buzëqeshur, bujaria, suksesit dhe përmendja përfshirë të mirë në mesin e popullit. Këto janë përfitimet e zotëruesit të mendjes përmes turpit. Lum ai që pranon këshillat e Allahut dhe që frikohet prej zbulimit të tij nga ana e Allahut.

## *Produktet e seriozitetit*

Produktet e seriozitetit janë: Dashamirësia, marrja e masave paraprake, zbatimi i amanetit, largimi nga tradhtia, të folurit e drejtë, të qenët i ndershëm (ruajtja nga prostitucioni), mirëmbajtja e mallit (duke e mbrojtur dhe duke e harxhuar me vend), parapërgatitja kundrejt armikut, shmangia nga e keqja dhe largimi nga pakujdesia. Këto janë përfitimet e zotëruesit të mendjes nga serioziteti. Lum ai që është serioz dhe që nuk është xhahil dhe mendjelehtë, i cili i fal të tjerët dhe që shtiret gjoja se nuk i vëren gabimet (të metat) e të tjerëve.

## *Produktet e punëve të mbarës*

Produktet e vazhdimësisë së punëve të mbarë: Braktisja e punëve të liga dhe të shëmtuara, largimi nga pamendja, shmangia nga mëkatet, arritja e bindjes së sigurt, dashuria ndaj shpëtimit, bindja ndaj të Mëshirshmit, të treguarit respekt ndaj argumentit dhe faktit, ruajtja nga shejtani, nënshtimi ndaj drejtësisë dhe të folurit e së vërtetës. Këto janë përfundimet e zotëruesve të mendjes që u përbahen vazhdimësisë së punëve të mbarë. Lum për atë që nuk e harron të ardhmen dhe ditën e ringjalljes, dhe që merr mësim prej kalueshmërisë së kësaj bote.



## *Produktet e urejtjes së të këqijave*

Produktet e urejtjes së të këqijave janë: Serioziteti, durimi, suksesit, të qenët në rrugën e drejtë dhe të qartë, vazhdimësia e rrugës së drejtë, mbështetja dhe respekti ndaj Allahut, pastërtia e brendshme, largimi nga punët e kota dhe ruajtja e punëve të dobishme. Këto janë përfitimet e atyre që nuk e donë sherrin. Lum për atë që e çojnë në vend hakun e Allahut dhe për atë që lidhen përlitarët e sigurt të Allahut.

## *Produktet e bindjes*

Produktet e bindjes ndaj atij që këshillon janë: Shtimi i diturisë, pjekuria e mendimit, fitimi i rezultateve pozitive, të qenët larg prej kritikave, pranimi i së vërtetës, miqësia, hapja e brendësisë, të qenët i mëshirshëm, tejkalimi i të tjerëve në punët e mbarës dhe të qenët i fuqishëm në bindjen ndaj Allahut. Lum për atë që është i shpëtar prej arenës së pasioneve dhe epsheve. Të gjitha këto kualitete morale, burojnë prej mendjes.

*Marrë nga libri "Dhuratë Mendjeve"*



# Çfarë është Agjërimi?

Dr. Ibrahim Emini

Agjërimi është njëri prej ibadeteve (adhurime) më të rendësishme i cili ka rol të veçantë gjatë kontrollimit të epshit. Për vlerën e agjërimit kemi shumë hadithe dhe thënie të dijaterëve. Resulullahi s.a.a. ( paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij) thotë: "Agjërimi është ibadet i cili të ruan nga zjarri i xhehenemit." Imam Sadiku a.s. thotë: "Allahu Teala ka thënë: "Agjërimi bëhet vetëm pér mua dhe unë e shpërblej atë që agjeron."

Në një hadith tjetër i dërguari i Allahut thotë: "Çdo kush që agjeron një ditë (agjërim jo obligativ me dëshirë-synet) pér sevapin e tij, atij i është bërë farz falja e mëkateve." Imam Sadiku a.s. ( paqja qoftë mbi të) thotë: "Çdo njëri nga ju i cili agjeron, gjumi i tij është ibadet, heshtja dhikër (përkujtim i Zotit) dhe i pranohet puna dhe duaja e tij." Transmetohet nga i Dërguari i Zotit të ketë thënë: "Allahu ka thënë: Përveç durimit (sabrit) të gjitha veprat tjera shpërblehen prej dhjetë deri në shtatëqind shkallë. Kurse pér durimin Unë do të shpërblej. Ndërsa sevapin e durimit vetëm Unë (Allahu) e di, vetëm agjërimi të bën të durueshëm."

Imam Aliu a.s. lidhur me Miraxhin nga i dërguari transmeton këtë hadith:  
"Pejgamberi në Miraxh kishte pyetur:  
- "Zoti im! Cili është ibadeti më i dobishëm? All-llahu xh.sh thotë: "Ibadeti më i dobishëm është heshtja dhe agjërimi.

Resulullahi prap:

- O Zoti im cila është vlera e agjërimit?

- All-llahu iu përgjigj:

**"Fruti i agjërimit është hikmet (urtësi), bëhet shkak i aftësisë, hap rrugën e saktësisë dhe kur arrin në saktësi pér njeriun nuk mbetet aspak frikë pér të jetuar deri në fund të jetës.**

Agjërimi mund të komentohet në dy mënyra.

**Mënyra e parë:** Nëse shikohet ana e jashtme agjërimi është largimi nga haja, pija dhe marrëdhënia intime, pastaj largimi, përgënjeshtrimi i Allahut dhe të dërguarit të Tij si dhe braktisja e të gjitha atyre gjérave që janë përmendur në librat e fikut, jurispodencës Islame.

**Mënyra e dytë:** Në të vërtet ky adhurim është i lidhur drejtperdrejt me besimin dhe brendësinë e shpirtit.

E vërteta e agjërimit është se pér hir të Allahut duhet të largohesh nga haramet ( gjërat e dëmshme dhe të ndaluar) por edhe nga disa hallalle pér një kohë të caktuar, si dhe ruajtja e epsheve dhe largimi nga haja, pija, kryerja e marrëdhënieve intime, gënjeshtra dhe nga gjërat të cilat e bëjnë agjërimin të pavlefshëm.

## DEFINICIONI I AGJËRIMIT

Në librat e fikut definicioni i agjërimit është kështu:

**"Agjërim do të thotë: largimi nga haja, pija, marrëdhëni intime, masturbimi gënjeshtra, përgënjeshtrimi Allahun dhe profetin e Tij, futja e kokës në ujë dhe ruajtja nga papastërtia duke**

**pasur për qëllim afrimin më afër Allahut prej mëngjesit (lindjes së diellit) deri në mbrëmje (perëndimit të diellit, kur të errësohet.“**

Mirëpo, nëpër hadithe agjërimi nuk është përkufizuar si më lart. Është thënë edhe më gjérë. Agjéruesi jo vetëm se duhet të ruhet nga haja, pijsa, por duhet të ruhet me gjithë organet e trupit. Si duhet të ruhet syri, veshi, gjuha, dora, këmba dhe organet tjera. Nëse shikohet edhe më lart, agjërimi më i mirë është i besimtarëve të devotshëm. Kështu pra agjéruesi pasi ta ketë ndaluar veten nga haja dhe pijsa, ai duhet ta ndalojë edhe prej veprave të cilat e largojnë dhe e pengojnë atë ta madhërojë dhe ta përkujtojë Allahun. E përgatit vetveten për gasti të Allahut.

Imam Sadiku thotë: “Agjërimi nuk është vetëm lënia e hajes dhe pijes. Kur të agjërosh duhet bashkë me ty të agjërojë: veshi, syri, gjuha, lukthi dhe epshi. Kur të agjërosh ruaju nga mëkatet e dorës dhe epshit dhe mos fol gjë të keqe, fol vetëm nëse ke nevojë. Agjéruesi duhet të sillet me kujdes, le të hesht pos kur ta përmend Allahun. Ditën kur agjëron mos bën ditë sikur kur nuk agjeron.

I Dërguari i Allahut thotë: “Çdo kush që gjatë muajit të ramazanit agjëron dhe heshtë, dhe gjithashtu veshin, syrin, gjuhën, epshin dhe pjesët e tjera të trupit e ruan nga gënjeshta, haramet dhe gibeti (thash e thëniet), ai vetveten e ndjen afër Ibrahimit a.s. që është quajtur Halilullah( shoku, jarani i Zotit) dhe i bashkohet Atij.”

Imam Sadiku a.s. thotë: “Agjërimi nuk është vetëm që të ruhemti nga haja dhe pijsa. Agjërimi për të qenë i plotë-fuqishëm ka një kusht, e ai është heshtja. ” Bija e Imranit Merjemja e shenjtë, njerëzve iu tha: “Unë e kam dhënë veten në agjërim për hir të Allahut. Atëherë sot nuk do të flas me askënd, pra nuk dëgjove se jam duke agjëruar për atë dhe nuk mund të flas me askënd? Kur agjëroni ruajeni gjuhën nga gënjeshta, mbyllni sytë nga harami, mos u grindni mes veti, ruajuni nga përgojimi nga gënjeshta dhe grindja. Mos i varni ftyrat tuaja. Mos kundërshtonit njëri tjetrin. Mos u nervozoni, mos fyeni, mos e prishni gojën tuaj, ruaju nga shtypja lufta dhe kryeneçsitë, ruaju nga sjelljet me injorancë dhe amoralitetit, mos iu përzini njëri tjetrin, mos e lëni anash dhikrin dhe namazin, jepni rëndësi heshtjes, mendimit, durimit, të vërtetës si dhe largohuni nga njerëzit e ligë. Sa pak janë ata të cilët agjërojnë dhe sa shumë janë ata të cilët vetëm qëndrojnë të uritur.

## ROLI I AGJËRIMIT GJATË EDUKIMIT SHPIRTËROR

Agjërimi është një ibadet (vepër adhurimi) mjaft i posaçëm dhe i vlershëm në qoftë se personi gjatë agjërimit respekton rregullat dhe edukatën e normave Islam dhe agjeron më mënyrë të drejtë, gjithashtu ndikon mjaft më edukimin dhe pastrimin e epshit. Agjërimi ka efekt të mjaftueshëm në pastrimin e epshit nga pisllëqet dhe mëkatet dhe më përfitimin e përkryerjes, boshatisjes (të

së keqes) dhe në pjesëmarrje hyjnore. Ai i cili agjëron me anë të braktisjes së mëkateve e frenon epshin emmare (shtazarak) dhe arrin ta futë nën kontrollin e tij.

Me agjërim hyjmë në luftës me epshit (pasionet) për edukimin të tij. Në këtë kohë kur lihen anash të gjitha, mandej edhe haja, pijsa dhe nga ushqimet të shijshme, ku duhet përpjekur vetëm për pastrimin e epshit nga mëkatet dhe pisllëqet, me anë të kësaj gjendjeje epshit i jep nur dhe qetësi. Ndërsa uria bëhet shkak i qetësimit të brendisë dhe i koncentrimit në Allahun. Kur njeriu është i uritur vazhdimisht qëndron i gëzuar, kurse kur barkun e ka të mbushur nuk mund ta gjesh këtë gjendje tek ai. Kështu që për të qenë i devotshëm mund t'i drejtohem agjërimit, andaj dhe në Kur'an thuhet: “O besimtar! Agjërimin e keni obligim të detyrueshëm, siç e kishin detyrë edhe ata që qenë para jush, ndoshta do të bëheni të devotshëm.” Deri këtu shpjeguam mbi rëndësinë e agjërimit për pastrimin nga mëkatet dhe pisllëqet. Prandaj agjërimi në përmasa të gjëra luan rol të rëndësishëm si p.sh. gjatë përkryerjes së epshit, gjatë pastrimit të brendësisë dhe gjatë afrimit më afër Allahut. Më poshtë do të shohim vetëm disa nga këto:

- Agjërim do të thotë të ruajturit e epshit dhe largimi nga disa gjëra të cilat e prishin agjërimin. Andaj, është një ibadet që ka ndikim të jashtëzakonshëm në edukimin e epshit, përkryerjes dhe në afrimin më afër Allahut.

- Me anë të braktisjes së gjérave të shijshme dhe mëkateve pastrohet dhe ndriçohet zemra e individit. Shpëton nga çdo përkujtim tjetër pos Allahut, fillon të marrë dhunti dhe të mira nga nuri i Allahut dhe bashkohet me Zotin. Kështu që radhitet nën përkujdesjen e Allahut. Ndërsa nëpër librat e haditeve është përmendor që frysma e gjumi i atij që është duke agjëruar janë ibadet.

- Derisa njeriu është në agjërim është koha më e mirë ibadet, namazit, leximit të Kur'anit, dhikrit dhe veprave të mira. Sepse zemra në këtë kohë është më e përgatitur se herave tjera, gjithashtu është edhe më e sinqertë dhe koncentruar në Allahun. Muaji i Ramazanit është koha më e mirë dhe është pranvera e ibadet dhe devotshmërisë. Për këtë dhe nëpër librat e duave është këshilluar shumë që në këtë muaj të bëhet ibadet dhe të adhurohet shumë Allahu. Imam Sadiku a.s. na mëson nga praktika e tij, se kur vinte muaji i Ramazanit fëmijëve të tij u thoshte: “Mundohuni të bëni ibadet më shumë, sepse në këtë muaj ndahet rishku (furnizimi, pasuria) e njerëzve dhe ripërcaktohet fati ynë për një vite ato jetë të ardhshme. Në këtë muaj bëhet e ditur se kush do t'i përgjigjet dhe do të shkojë tek Allahu. Gjatë këtij muaji është një natë që ibadeti i bërë është më i vlershëm se ibadeti i njëmijë netëve tjera.”

Imam Aliu a.s. thotë: “Lutuni shumë gjatë muajit të Ramazanit, pendohuni. Kështu që pëershakat të lutjeve tuaja u hiqen belatë (fatkeqësitet), kurse me anë të pendimit tuaj u falen mëkatet.”

# Imam Xhafer Sadiku

## Një rishikim i shkurtër i biografisë së Imam Sadikut (a.s.)

Imami i gjashtë quhej Xhafer, ndërsa ishte i njohur edhe si Ebu Abdullah si dhe me ofiqin Sadik (i sinqerti). Babai i tij i nderuar ishte Imam Bakiri, a.s., ndërsa nëna i quhej Ummi Feruh.

Kishte lindur më 17 Rebiul-evvel të vitit 83, sipas Hixhrës në Medinë, ndërsa vdiq në moshën 65 vjeçare, në vitin 148 sipas Hixhrës, dhe u varros pranë varrit të babait të tij në varrezat e njohura Bekija në Medine.

## Kalifët bashkëkohës të Imamit

Imam Sadiku, a.s., e mori imamatin në vitin 114 H., dhe periudha e imamatit të tij përputhet me fundin e pushtetit emevit, i cili përfundoi në vitin 132 H., respektivisht me fillimin e pushtetit abasid që nisë në vitin në fjalë.

Kur është fjalë për kalifët abasid, bashkëkohës të tij ishin: Abdullah ibn Muhammedi, i njohur si Sefahu si dhe Ebu Xhaferi, i njohur si Mensur Devaniki.

## Arsimimi i Imam Sadikut, a.s.

Për madhështinë shkencore të Imam Sadikut, a.s., ekzistojnë shumë dëshmi dhe në këtë pikëpamje nuk ka kurrfarë mospajtimesh mes dijetarëve sh'iit dhe sunnit. Fukahatë (shkencëtarët e fikhut) dhe dijetarët e mëdhenj ulin kokën para madhështisë shkencore të Imamit dhe pranojnë përparësinë e tij në dije.

## Ebu Hanifja dhe Imam Xhafer Sadiku a.s.

Ebu Hanifa, themeluesi i famshëm i medh'hebit hanefi ka thënë: "Nuk kam takuar asnje njeri më të ditur se Xhafer ibn Muhammedin." Gjithashtu ka thënë: "Kur Mensuri (Devaniki) në një rast e kishte ftuar Xhafer ibn Muhammedin tek ai, më tha: "Njerëzit i janë besnik Xhafer ibn Muhammedit.

Prandaj përgatit disa pyetje të vështira juridike të cilat do t'iа shtrojmë dhe ta mundim." Kështu, përgatita dyzetë pyetje të vështira. Një ditë Mensuri më ftoi në Hira (pallati i tij). Kur hyra në tubim pashë që Xhafer ibn Muhammedi ishte ulur në anën e djathtë të Mensurit. Kur e shikova, dinjiteti i tij dhe madhështia në mua lanë përshtypje të cilën kurrë nuk e kisha ndjerë kur e shikoja Mensurin.

Mensuri pastaj i drejtohet: "Ky është Ebu Hanifa", ndërsa ai u përgjigj: "Po, e njoh." Pastaj Mensuri tha: "O Ebu Hanife, diskutoi çështjet tuaja me Ebu Abdullahun (Xhafer ibn Muhammedin)!" Atëherë fillova të shtroja pyetje. Çkado që pyesja ai më përgjigjej: "Ju në lidhje me këtë thoni kështu, Medinasit ashtu, ndërsa ne konsiderojmë me sa vijon..." Për sa i përket disa çështjeve u pajtua me ne, për disa të tjera u pajtua me Medinasit, ndërsa për disa çështje nuk u pajtua me asnjërin qëndrim. Kësisoj ia shtrova dyzetë pyetje dhe mora përgjigje në secilën. "Kur përfundoi kjo, Ebu Hanifa tregoi në Imam Sadikun, a.s., dhe tha: "Më i dituri mes njerëzve, më i informuari për kontestimet e njerëzve kur është fjalë rrëth dallimeve në fetva dhe çështje të fikhut."



## **Enes Ibn Maliki dhe Imam Sadiku a.s.**

Enes ibn Maliku, themeluesi i medh'hebit Maliki, thotë: "Një kohë e kisha vizituar Xhafer ibn Muhammedin, dhe gjithmonë e gjeja në një nga tri gjendjet: ose falej, ose agjéronte ose recitonte Kur'an. Kurrë nuk e kisha parë që pa abdest të transmetonte ndonjë hadith. Sytë nuk më kishin pa dikend më të devotshëm dhe më të përulur se sa Xhafer ibn Muhammedi, as veshët s'ma kishin dëgjuar, dhe as zemra nuk kishte mbajtur mend një tjetër."

Shejh Mufidi shkruan: "Nga Imami është transmetuar aq dituri sa që njerëzit flisnin vetëm për të dhe fama rrëth tij kishte arritur kudo. Nga askush prej familjes së tij nuk është përcjellur më shumë diej e shkencë se sa nga ai."

Ibn Haxher Hejthemi shkruan: "Nga ai është transmetuar aq dituri sa që njerëzit flisnin vetëm për të dhe fama rrëth tij kishte arritur kudo.

Ebu Bahr Xhahizi, një nga dijetarët e famshëm nga shekulli i tretë, i hixhretit thotë: "Xhafer ibn Muhammedi është ai shkenca dhe dija, e të cilit e kanë mbushur botën. Thotë se nxënësit e tij ishin Ebu Hanifa dhe Sufjan Theuri, ndërsa nxenia e këtyre dyve nga ai është dëshmi e

mjaftueshme për madhështinë e tij."

Sejjid Amir Aliu, duke bërë me dije për grupimet dhe shkollat filozofike nga periudha e sundimit të emevitëve shkruan: "Fetvatë dhe mendimet fetare vetëm te fisnikët dhe personalitetet e jashtëzakonshme nga pasardhësit e fatimes kishin aromën filozofike."

Në ligjëratat e tij nuk merrnin pjesë vetëm ata të cilët më vonë do të themelojnë medhhebe të fikhut, por edhe filozofë dhe ihtarë të filozofisë nga të gjitha anët e botës së atëhershme. Hasan Basriu, themelues i shkollës filozofike të Basras, dhe Vasil ibn Ata', themelues i idesë mutezilite, ishin nxënës të tij dhe etjen e tyre e shuanin nga burimet e dijes së tij."

Historiani i famshëm Ibn Halikani shkruan: "Ai është një nga dy mbëdhjetë imamët e medh'hebit imami dhe një nga dinjitarët e familjes së pejgamberit, ndërsa për shkak të drejtësisë dhe të folurit të drejtë ishte quajtur Sadik. Virtuti dhe madhështia e tij është diçka tepër e njohur sa që nuk ka nevojë për shpjegime të tjera. Ebu Musa Xhabir ibn Hajan Tertusu ishte nxënës i tij. Xhabiri është autor i librit mijafaqesh që përbante mësimet e Xhafer Sadikut përmes pesëqind traktateve."

## **Situata politike, shoqërore dhe kulturore në kohën e Imamit**

### **Kushtet e veçanta kulturore**

Në pikëpamje intelektuale dhe kulturore periudha e Imam Sadikut, a.s., ishte periudhë e turbulencave. Në atë kohë në shoqërinë islame ishte paraqitur një vrull i paparë shkencor dhe elan, dhe në skenë dalin shkenca të ndryshme, prej atyre islame si kiraeti i Kur'anit, tefsiri, shkencat mbi hadithin, fikun dhe kelamin, deri te shkencat shoqërore si mjekësia, filozofia, astronomia, matematika etj, ashtu që secili që kishte diçka për të ofruar në pikëpamje intelektuale, e shfaqte në tregun e dijes dhe shkencës. Pra, fjalë ishte për urë të jashtëzakonshme për dijen, ashtu që ishte e nevojshme që Imami të përgjigjej në të.

Faktorët që shkaktuan këtë lëvizje shkencore do të mund t'i sublimonim me sa vijon:

1. Liria e ideve dhe e bindjeve në islam. Gjithsesi, as abasidët nuk ishin pa ndikim kur është fjalë për paraqitjen e kësaj lirie intelektuale, por rrënjet e saj gjenden në vetë botëkuptimin islam, ashtu që Abasidët edhe po sikur të donin, një gjë të tillë nuk do të mund ta ndalonin.

2. Atmosfera e atëhershme në shoqëri është kryekëput islame dhe populli ishte nën ndikimin e madh të religjionit. Porositë e pejgamberit të islamit që të gjurmohet për shkencën dhe nxitjet e Kur'anit si dhe thirrjet për të mësuar dhe menduar ishin nxitja bazë e këtij vrulli dhe elani shkencor.

3. Popujt dhe kombet, të cilat së fundit kishin pranuar islamin kishin një të kaluar të pasur intelektuale dhe shkencore, e disa prej tyre, si p.sh., iranianët (të cilët kishin të kaluarën shkencore më të shkëlqyer), egipetianët dhe sirianët vini nga qendrat e qytetërimeve të atëhershme. Ata njerëz, duke e kuptuar thellë botëkuptimin islam iu qasën studimit, hulumtimit dhe shkëmbimit të mendimeve.

4. Toleranca fetare, respektivisht bashkëjetesa paqësore me jomyslimanët, sidomos me ihtarët e Librit. Myslimanët toleronin ihtarët e Librit dhe atë nuk e konsideron të kundërt me parimet e fesë. Ihtarët e Librit në atë kohë konsideroheshin për të ditur dhe njerëz të arsimuar. Myslimanët kishin realizuar kontakte shkencore me ta, ndërsa kjo kishte bërë që të zhvilloheshin diskutime, analiza dhe shkëmbim mendimesh.

### **Paraqitja e sekteve dhe medhhebeve**

Koha e Imam Sadikut, a.s., ishte periudhë e paraqitjes së ideve të sekteve të ndryshme dhe medhhebeve ( shkollave juridike ). Si pasojë e takimit të myslimanëve me idetë dhe pikëpamjet e ihtarëve të Librit dhe filozofëve grek paraqiten çështje dhe dilema të ndryshme.

Në atë kohë paraqiten sekte të ndryshme si; mutezilitë, xhebritë, murxhitë, gulatët, zindikët, mushebihët, mutesavifët, muxhesemijtë, tenashijtë dhe të tjerëve, dhe secila prej tyre përpinqej të përhapte idetë e saj.

Përveç kësaj, në pikëpamje të çdo shkencë islame paraqiteshin dallime mes shkencëtarëve që merreshin me to, dhe kështu zhvilloheshin polemika të zjarra rreth çështjeve të kiraëtit të Kur'anit, tefsirit, hadithit, fikhut dhe kelamit, me ç'rast secila palë përfaqëson dhe mbronte qëndrimet e veta.

## Universiteti i madh i Xhaferit

Imam Sadiku, a.s., duke pasur parasysh rrethanat e përshtatshme politike dhe nevojën e madhe si dhe gatishmërinë e shoqërisë, vazhdoi lëvizjen shkencore dhe kulturore të babait të tij Imam Bakirit, a.s., dhe krijoj shkollën e madhe shkencore, respektivisht universitetin, ku në shkenca të ndryshme fetare dhe shoqërore kishte shkolluar nxënës të famshëm si Hisham ibn Hakemin, Muhammed ibn Muslimin, Aban ibn Teglibin, Hisham ibn Salimin, Mumin Takun, Mufaddal ibn Omerin, Xhabir ibn Hajjanin etj., ndërsa numri i tyre arriti deri në katërmijë veta.

Secili prej atyre nxënësve konsiderohej si person me autoritet dhe i ditur, dhe meritat e tyre të mëvonshme janë të mëdha. Disa prej tyre kishin shkruar vepra shkencore dhe kishin numër të konsiderueshëm të nxënësve. Kështu, p.sh., Hisham ibn Hikemi shkroi tridhjetë e një vepra, ndërsa Xhabir ibn Hajjani është autor i më shumë se dyqind vëllimeve të librave në disiplina të ndryshme shkencore, sidomos nga sferat e shkencave racionale dhe shkencore si dhe kimisë (e cila atëbotë quhej alkimi), prandaj edhe njihet si babai i kimisë. Librat e Xhabirit në mesjetë janë përkthyer në gjuhë të ndryshme evropiane dhe të gjithë historianët e shkencës e përmendin me pietet.

## Gjerësia e universitetit të Imam Sadikut (a.s.)

Nxënësit e universitetit të Imam Sadikut, a.s., nuk ishin vetëm shi'itët, por në ligjératat e tij merrnin pjesë edhe sunnitë. Prijësit e rëndësishëm të botës sunnite, drejt-përdrejtë apo tërthorazi ishin nxënës të Imamatit. Më i dalluari prej tyre padyshim ishte Ebu Hanifa, i cili dy vjet ishte nxënës i Imamatit. Ai ato dy vite i përmend si themel të dijes së tij dhe thotë: "Po sikur të mos ishin ato dy vite, Numani (Ebu Hanifa) do të dështonte."

Për gjerësinë e universitetit të Imamatit mjafton të përcjellim fjalët e Hysein ibn Ali ibn Zijad Veshshas, i cili natyrish, me vite kishte jetuar pranë Imam Sadikut, a.s., ai thotë: "Në xhaminë e Kufës kam parë nëntëqind mësues të hadithit dhe të gjithë i transmetonin hadithet nga

Xhafer ibn Muhammedi."

Jaf'i shkruan: "Ai fliste hollësishët për shkencën e teuhidit dhe çështjet e tjera. Nxënësi i tij Xhabir ibn Hajjani kishte shkruar librin prej rreth dyqind fletësh, i cili përbante rreth pesëqind traktate."


Imam Sadiku, a.s., e shtynte secilin nxënës të tij që të merrej me atë disiplinë për të cilën tregonte më së shumti talent dhe që i pëlqente më së shumti, dhe secili prej tyre ishte veçanërisht i dalluar në një apo dy disiplina shkencore si hadithi, tefsiri, kelami etj.

Ndonjëherë Imamë shkencëtarët që e vizitonin me qëllim të shqyrtimëve dhe diskutimeve i udhëzonte të shkonin te nxënësit e tij të cilët ishin të specializuar në disiplina të veçanta shkencore.

## Imami dhe Siriani

Hisham ibn Salimi thotë: "Njëherë me një grup shokësh të Imam Sadikut, a.s., po rrija ulur në praninë e tij. Një njeri nga Shami kërkoi leje për të hyrë, dhe pasi iu lejuau u bashkëngjitur edhe ai. Imami i tha të ulej, mandej e pyeti: "Çka dëshiron? Siriani i tha: "Kam dëgjuar që ju i përgjigjeni njerëzve në të gjitha pyetjet dhe problemet, prandaj kam ardhur të diskutoj me ju! Imami pyeti: "Në lidhje me çka? Siriani u përgjigji: "Për mënyrën e leximit të Kur'anit. Imami atëherë iu drejtua Hamranit dhe i tha: "Hamran, ti duhet t'i përgjigjesh këtij njeriu. Siriani ndërhyri: "Por unë dëshiroj të diskutoj me juve, e jo me Hamranin!, ndërsa Imami iu përgjigji: "Po e munde Hamranin, më ke mundur edhe mua!

Kësisoj Siriani u detyrua të diskutonte me Hamranin. Çkado që pyeste Siriani, Hamrani i jepte përgjigje të prerë dhe të argumentuar, ashtu që në fund, edhe pse jo i kënaqur dhe me hidhërim, hoqi dorë nga diskutimi. Atëherë Imami i tha: "Si të duket Hamrani?, ndërsa ai u



përgjigj: "Vërtetë, Hamrani është shumë i shkathët; çkado që e pyeta, m'u përgjigj në mënyrë të duhur!

Mandej Siriani tha: "Do të dëshiroja të diskutoja me ju për gjuhën arabe dhe letërsinë. Imami iu drejtua Aban ibn Taglibit dhe i tha: "Diskuto me të. Abani në diskutim tërësisht dominoi dhe në gjithçka ia kaloi Sirianit. Siriani i tha Imamit: "Do të doja të diskutoja me ju për fikhn. Imami atëherë iu drejtua Zurares: "Diskuto me të, dhe Zurare u fut në diskutim dhe shpejtë e la atë njeriun pa tekst.

Siriani mandej tha: "Do të doja të diskutoja me ju për kelamin, ndërsa Imami i tha Mumin Takut që ai të diskutonte. Shumë shpejt Siriani u mund në diskutim me Mumin Takun.

Më tutje Siriani kërkoi që të diskutonte për istiteatin (aftësinë e njeriut të bëj respektivisht të mos bëj keq), teuhidin dhe imamatin, ndërsa Imami për këto diskutime i caktoi Hamza Tajjarin, Hisham ibn Salimin dhe Hisham ibn Hakimin, dhe secili me argumente të duhura dhe të pakontestueshme e mundi Sirianin. Duke parë këtë pamje të gëzueshme, buzët e Imamit u zgjatën në buzëqeshje të embël."

### Traktati i Mufaddelit për teuhidin

Siq e bëmë me dije, Imam Sadiku, a.s., ishte marrë me shkencat natyrore dhe në lidhje me to kishte zbardhur shumë fshehtësi të cilat habisin edhe shkencëtarët bashkëkohor. Dëshmi e qartë për këtë (përveç dijes së Xhabirit) është traktati i Mufaddelit për teuhidin, (prë njëshmërinë e Zotit) të cilin Imami e kishte diktuar gjatë katër ditëve, ndërsa Mufaddeli e kishte shënuar, prandaj na është i njobur si Teuhidi i Mufaddelit.

Vetë Mufaddeli në hyrje të këtij traktati thotë: "Në një rast, në kohën e akshamit, isha ulur në xhaminë e Pejgamberit, duke menduar për madhështinë e Pejgamberit dhe virtyetet e nderin të cilin ia kishte dhuruar Allahu. Isha në këto mendime dhe përnjëherë në xhami hyri Ibn Ebul-Avxha, një nga zindikët e atëhershëm, dhe u ul aq afër sa që mund ta dëgjoja. Së shpejti erdhi edhe një nga miqtë e tij dhe u ul me të. Ata të dy nisën të flisnin për Pejgamberin e islamit... Atëherë Ibn Ebul-Avxha tha: "Lëre emrin e Muhammedit, sepse ai e ka mahnitur mendjen time, dhe mendja ime nuk mund ta kuptoj vepren e tij, dhe fol për parimin që ai e solli. Atëherë filluan të flisnin për krijuesin e botës dhe thanë gjëra të tillë kinse bota nuk ka krijues dhe drejtues, por që gjithçka ndodh vetveti, që kësisoj ishte gjithmonë dhe përgjithnjë do të mbeten kështu."

Mufaddeli tutje deklaron: "Kur dëgjova këto budallallëqe, larg nga çdo mëshirë e Zotit nuk munda ta frenoja zemërimin tim, prandaj thashë: "O armik i Allahut, je bërë ateist, prandaj po e mohon Allahun i cili të krijoi në

formën më të bukur, të kaloi nëpër gjendje të ndryshme dhe të bëri kështu siç je! Nëse mendon për vetën dhe përpinqesh ta kuptosh vetveten, në vetën tënde do të gjëje dëshmi për Allahun dhe do të shihje që në ty janë dëshmitë e qarta të ekzistencës së Allahut dhe fuqisë së Tij, si dhe shenja të dijes dhe urtësisë."

Ibn Ebul-Avxha tha: "Njeri, nëse je nga ata që dinë të diskutojnë në mënyrë të argumentuar, do të flas me ty në atë mënyrë, dhe nëse më mund në polemikë do ta pranoj atë që ti e thua. E nëse megjithatë nuk je i tillë, nga biseda me ty nuk ka kurrfarë dobie. E nëse je ndonjë nga shokët e Xhafer ibn Muhammed Sadikut, dije që ai nuk na thotë gjëra të tillë dhe nuk na drejtohet në këtë mënyrë.

**Imam Xhafer Sadiku shumë herë kishte dëgjuar nga ne çështje më të mëdha se sati, dhe kurrë nuk na ka ofenduar, dhe në polemikat tona nuk kishim kaluar kufijtë e mirësjelljes. Ai është i qetë, i përbajtur dhe i urtë, dhe kurrë nuk shpreh zemërim apo nguti. Dëgjon fjalët dhe argumentet tona, dhe na lejon t'i themi të gjitha ato që kemi për të thënë, ashtu që mendojmë se e kemi mundur. E atëherë me pak fjalë na i rrëzon argumentet tona dhe fare shkurtë plotëson argumentin e tij mbi ne, ashtuqë na lë pa përgjigje të duhur. Prandaj, nëse je ndonjë nga pasuesit e tij, na u drejto ashtu siç i ka hije atij."**

Mufaddeli thotë: "Mandej i pikëlluar dola nga xhamia, dhe duke menduar për dëmin që islamit dhe myslimanëve ua sjellin këta jobesimtarë me dyshimin dhe mohimin e tyre të Allahut, shkova te prijësi im Imam Sadiku, a.s.. Kur më pa të pikëlluar dhe mërzitur, Imami pyeti: "Çfarë të ka ndodhur? Ia përcolla Imamit fjalët e atyre të pafeve, ndërsa ai më tha: "Do të ta mësoj urtësinë e Krijuesit në krijimin e botës, shtazëve, bishave, insekteve, zogjve dhe të gjitha qenieve të gjalla, njerëzve, barit, drunjve frytdhënës dhe shterpë, vajit të ushqyeshëm dhe të paushqyeshëm, ashtu që ata të cilët marrin mësim edhe më shumë t'i shtojnë njoburitë e besimtarëve, e që të pafetë dhe ateistët të mbeten të mahnitur para saj. Nesër në mëngjes eja tek unë."

Dhe kësisoj Mufaddeli katër ditë rresht shkoi tek Imam. Imami ia shpjegoi krijimin e njeriut që nga fillimi i krijimit, përfuqitë e jashtme dhe të brendshme, përvitetë e lindura të njeriut, krijimin e organeve të njeriut, përkrijimin e llojeve shtazore, krijimin e qiejve dhe Tokës..., si dhe përfilozofinë e fatkeqësive që ndodhin dhe çështje të ngjashme, ndërsa Mufaddeli shënon. Traktat i Mufaddelit për teuhidin shumë herë është botuar si libër i veçantë.

# Karakteristikat e Kuranit Fisnik

Islami është një mesazh i bazuar në praktikën shkencore dhe dispozitat intelektuale me fazë të urdhëruara në mënyrë sistematike duke filluar me të Profetësinë e shquar, tipar kryesor i të cilit është mrekullia e Kuranit të Shenjtë, i cili është shpallur për të revokuar dhe për të zëvendësuar të gjitha fetë dhe mesazhet e mëparshme hyjnore.

Kurani është:

Libër i rrjedhshmërisë dhe prozës së mirë që përfshin pasuritë e gjuhës Arabe.

Është Libër i vargjeve, melodive, i embëlsisë dhe butësisë.

Është Libër, i të kuptuarit, i tèresisë së përsosur, i thellësisë, përsosmërisë, urtësisë dhe elokuencës.

Është Libër i njojurive të pashembullta që përqafon të gjitha rrëthanat.

Është Libër që trajton karakterin e lindur dhe pëshpërit në thellësitë e zemrës dhe mendjes, duke i liruar ata për t'u përgjigjur.

Kur Kurani i shenjtë u shpall me këto karakteristika të stilit, aranzhimit dhe tekstit, njerëzit kishin nevojë për më shumë njojuri për të shpjeguar vargjet e tij, për të hedhur dritë mbi elokuencën e tij, për të shqyrtuar fjalët e tij me kuptimet e tyre të thella, dhe të zbulojnë thelbin e tij.

Shkolla e Ehli Bejtit ( Familjes profetike) ka përvetësuar të njëjtën metodë për të zbatuar dytyrat e Profetit të madh të Islamit në shpjegimin, sqarimin dhe zbulimin e kuptimeve të Kuranit të Shenjtë, dhe kjo ka qenë edhe burimi dhe pikë e referimit që pasqyron përbajtjen e singertë dhe thellësinë e vërtetë të Islamit dhe të mesazhit të Muhamedit paja e Zotit qoftë mbi të dhe familjen e tij.

# Islami, pasqyrë e karakterit

Islami, në qendër të vëmendjes, ka mbarëvajtjen dhe zhvillimin e karakterit të njeriut, ose siç mund të thuhet ndryshe, Islami është feja e karakterit. Feja islame ka vendosur një ekuilibër midis të gjitha dimensioneve të karakterit dhe instinkteve të tij dhe asnjë nga këto nuk e mban të ndrydhur, duke krijuar kështu kushte të favorshme për zhvillimin e tyre paralel. Në mësimet islame mund të gjenden shumë shembuj që përbajnë këshilla dhe instrukSIONE për zhvillimin e secilit prej dimensioneve të karakterit. Të gjitha këto tregojnë qartë se mësimet islame bazohen në karakterin e njeriut.

Po ashtu, në Islam, me të njëtin kujdes dhe përpikëri trajtohen edhe instinktet trupore të njeriut. Arsyja e kësaj vëmendjeje është se feja islame u dërgua nga Ai që e krijoj karakterin e njeriut dhe vetë njeriun, për ta udhëhequr atë deri në fund. Këto tregojnë se ekziston një përputhje dhe harmoni e plotë midis krijimit (ekzistencës, gjenezës) dhe vendosjes së ligjeve të Islamit, pra, gjithçka është në ekuilibër të përsosur. Edhe Kur'ani i Madhëruar, në lidhje me këtë pikë, sqaron:

**“Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit.”** (“Sure Rrum”, ajeti 31)

Islami është një fe që nuk njeh ngjyrë vjetërsie, nuk plaket. Plakje dhe dalje jashtë kohës do të kishim në rast se nuk do të ekzistonte karakteri i njeriut me të gjitha dimensionet e veta.

**Ligjet, traditat dhe zakonet, që shoqëritë e ndryshme vendosin mbi njerëzit, do të bëhen pre e harresës dhe e zëvendësimit të tyre, nëse këto ligje nuk përputhen me karakterin e njeriut dhe nuk janë për ngritjen dhe zhvillimin e tij në përgjithësi. Përkundrazi, ligjet që vendosen në bazë të nevojave të karakterit të njeriut dhe i japin gjithmonë përgjigje atij në çdo kohë është e pamundur të vjetërsohen.**


A mund të imagjinohet ndonjëherë që dimensionet e karakterit të njeriut, si për shembull kërkimi i së vërtetës, drejtësia, pastërtia njerëzore, guximi, etj, si këto, të bëhen të pavlera për njeriun? Kjo është arsyja që feja qiellore dhe ligjet e saj, me kalimin e shekujve, nuk vjetërsohen, por përkundrazi, vlera e saj mbetet përherë e vlefshme për njerëzit.

## Njeriu dhe liria

**“Kushti më i rëndësishëm dhe më i domosdoshëm që njeriu të arrije lumturinë e merituar nuk është gjë tjetër veçse zgjedhja e lirisë dhe e dëshirës së tij.”**

Një nga pikat kryesore të njohjes së njeriut është liria e tij. Kuptimi i lirisë është pikërisht i kundërt me detyrimin, domethënë, njeriu mund të veprojë me dëshirën e tij ose mund ta detyrojnë të kryejë një veprim pa dëshirën e tij, pra, kur është vetë shkaktar i një veprimit me vetëdije ose kur kemi të bëjmë me forca të tjera të jashtme që nuk kanë të bëjnë me këtë njeri që vepron.

Nuk duhet harruar se fjala liri nuk nënkupton që njeriu mund të bëjë ç'te dojë, po ashtu të gjitha veprimet që ndodhin gjatë një kohe të caktuar tek një individ nuk kanë ardhur tërësisht si rrjedhojë e lirisë së tij, pra, dëshira dhe preferencat e tij nuk kanë pasur rolin më të vogël në këto ngjarje.



Duhet theksuar se tèresia e vlerave të karakterit të njeriut lidhet ngushtë me lirinë e tij dhe prania e lirisë bën të mundur zgjerimin e dimensioneve të karakterit dhe asnjëherë nuk mund të zhvillohen më lart se sa e lejon liria. Njeriu ka pér detyrë të aplikojë dëshirën dhe lirinë që ka. **Në bazë të këtij arsyetimi mund të themi se kushti më i rëndësishëm dhe më i domosdoshëm që njeriu të arrijë lumturinë e merituar nuk është gjë tjetër veçse zgjedha e lirisë dhe e dëshirës së tij.**

Në brendësi të njeriut ka disa ndjenja shpirtërore që, shkencat që ne njohim dhe aplikojmë përditë, nuk u përgjigjen dot pyetjeve tonë në lidhje me to. Pra, këto ndjenja nuk kanë nevojë pér ndonjë vërtetim, sepse njeriu, në mënyrë të drejtpërdrejtë i ka të bashkangitura në karakterin e tij dhe është i vetëdijshëm pér ekzistencën e tyre, siç është i vetëdijshëm pér ekzistencën e vërvetës. Pér shembull, njeriu gëzohet, ndien frikë dhe pér këto ndjenja ai mund të shpjegojë vetë gëzimin, frikën, e të tjera si këto pa pasur nevojë pér ndonjë shkencë të përpunuar, ose ndonjë ndërmjetës tjetër që të na vejë në dijeni pér ekzistencën e tyre. E vërteta është se njeriu është në gjendje të vetë perceptoje me saktësi absolute dhe pa pikë dyshimi se me cilën ndjenjë ka të bëjë sipas rastit.

Nëse dikush do t'ju pyeste se me çfarë arsy e vërtetoni ju gëzimin apo trishtimin tuaj, ju si do t'i përgjigjeshit? A ka ndonjë lloj arsyetimi logjik pér të vërtetuar një gjë të tillë? Natyrisht që jo. Dëshira është një e vërtetë që njeriu e ka pranuar dhe e njeh në brendësinë e tij. Pér ta kuptuar më mirë këtë gjë po jepim një shembull të thjeshtë: Supozoni një njeri që është i sëmurë me të dridhura të forta dhe nuk i kontrollon dot duart e tij, pra, duart e tij veprojnë në mënyrë jo normale dhe me një farë detyrimi. Në rast se ky njeri do të kryejë një punë, do t'i nënshtrohet dëshirës së tij, pér shembull në zhvendosjen e një objekti nga tryeza pér në një vend tjetër. Veprimi i parë i ngritjes së objektit është i detyruar, kurse se në ç 'vend do ta vendosë atë është në dëshirën e personit. Këto gjëra janë të mirënjohnura nga njeriu. Megjithëse dëshira tek njeriu dallohet qartë, ka disa faktorë që tregojnë ekzistencën e saj. Disa prej tyre do t'i diskutojmë më poshtë:

**Të menduarit dhe të duruarit:** Në momente të ndryshme, njeriu, përpara se të kryejë një veprim, mendohet duke e vlerësuar nga shumë pikëpamje dhe në shumë raste qëndron në pritje, duke duruar presione të ndryshme derisa ta kryejë atë. Arsyja, që njeriu vepron në këtë mënyrë, është se ai është plotësisht i lirë në zgjedhje dhe është i shqetësuar se mos gabon, pra, mendimi dhe durimi tek njeriu janë tregues të lirisë në zgjedhje tek ai.

**2- Turpi dhe pendimi:** Një tregues tjetër i ekzistencës së lirisë te njeriu është ndjenja e turpit dhe e pendimit. Në qoftë se njeriu nuk do të gëzonte lirinë në veprimet e tij, ai asnjëherë, pas kryerjes së ndonjë veprimi, nuk do të pendohej apo do të turpërohej pér gabimin që mund të bëjë. Pra, vetë ndjenja e turpit dhe e pendimit merr kup-

tim vetëm kur njeriu mund të zgjedhë para se të veprojë.

**3- Përgëzimi dhe ndëshkimi:** Po ashtu, edhe ky grupim rregullash në shoqëri thekson me forcë pér lirinë që ka njeriu në zgjedhjen e tij. Është e qartë se përgëzimi, vlerësimi material, pozitiv apo negativ, si dhe ndëshkimi janë disa rregulla në çfarëdolloj shoqërie njerëzore, që kanë kuptim vetëm në rast se njeriu ka mundësi të zgjedhë me kushte të lira. Asnjë dijetar nuk do ta pranonte, pér shembull, ndëshkimin në kushte të një veprimi të detyruar dhe pa dëshirën e vepruesit.

**4- Sistemi i arsimimit dhe i edukimit:** Nuk ka asnjë dyshim se, në shoqëritë njerëzore, ekzistojnë sisteme zinxhir të mirë organizuara edukimi dhe arsimimi, pér të vetmin qëllim që njeriu të ketë mundësi pér të vepruar në mënyrë të drejtë dhe të rrissë aftësinë e tij në zgjedhje. Në qoftë se ai nuk do ta kishte një liri të tillë në zgjedhje, a do të kishte vend pér edukimin e tij?

#### Mos kundërshtimi i lirisë në zgjedhje

Liria në zgjedhje, tek njerëzit, është një fakt i pamohueshëm. Megjithatë, në shoqëri të ndryshme, ka njerëz që e hedhin poshtë këtë fakt dhe nuk e pranojnë që njeriu mund të zgjedhë i lirë. Pér këtë sjellin fakte dhe arsyetojnë në një mënyrë absurde, sa mohojnë dhe ekzistencën e tyre. Ka të tjerë që e mohojnë me fjalë, por në praktikë, kur vihen përballë veprimit, detyrohen ta pranojnë në një farë forme, gjë që tregon se vetë ata, në thellësinë e brendësisë së qenies së tyre, e pranojnë këtë fakt të pamohueshëm.



Shkencëtar i madh islam, Abu Ali Sina (Avicenna), në lidhje me këtë temë shpjegon:

**"Mënyra më e mirë pér të bindur njerëz të tillë është të atakohesh në mënyrë të drejtpërdrejtë me ta dhe të argumentosh se nuk është zgjedhja juaj, por se ishit të detyruar të përballeshit me njëritjetrin, kështu që ata do ta kuptojnë hilen dhe do të zgjohen nga kjo gjendje e plogët mendimi."**

#### Liria dhe filozofia profetike

**"Sipas të gjitha feve qiellore, njeriu është një krijesë që zgjedh dhe, në bazë të kësaj zgjedhjeje, përcakton fatin e tij."**

Baza e tē gjitha feve qiellore është aftësia që ka njeriu pér tē zgjedhur. Kjo liri nē zgjedhje nuk është e kufizuar nga asnjë faktor fizik ose natyror. Kjo përbën pikën mbështetëse të feve, së bashku me sistemet përkatëse edukativo-morale. Siç dihet, nē kohët e hershme, profetët, njëri pas tjetrit, e kanë ftuar njerëzimin drejt rrugës së drejtë dhe t'i shmanget veprimeve të ndaluara.

Përkatësish, nga secila fe, lind pyetja: Në qoftë se njeriu nuk do të kishte të drejtën e zgjedhjes, a do të kishte kuptim kjo ftesë profetike? Pra, profetët, duke e ditur më së miri një aftësi të tillë te njeriu, i kanë drejtuar atij një ftesë të tillë logjike, të mbështetur më së miri te karakteri i zgjedhjes së tij të lirë.

Profetët, përvëç udhëzimeve që jepnin pér rrugën e drejtë dhe predikimeve që bënин, kishin pér detyrë të vinin nē dijeni njerëzit pér parajsën dhe ferrin. Kjo detyrë e profetëve mbështetet plotësisht te aftësia që ka njeriu pér tē zgjedhur rrugën e tij. Po ashtu, shprehjet që profetët propagandonin pa pushim, si: përgjegjësia, provat që njeriu jep nē jetë, ndëshkimet, udhëheqja, qorrolisja, etj, a do të kishin kuptim nëse njeriu do të kryente gjithçka si një makinë e mirëprogramuar qysh më parë, nē ményrë që tē veprojë me përpikëri siç e kérkon inxhinieri i saj dhe pa asnjë shmangje nga programi? Në Kur'anin Famëlartë shkruhet: "Natyrish që Ne i treguan atij rrugën e drejtë, që ai tē jetë ose mirënjohës, ose mos-mirënjohës." (Sure "Insan", ajeti: 3)

Pra, arrijmë nē përfundimin se, sipas të gjitha feve qiellore, njeriu është një kriesë që zgjedh dhe, nē bazë të kësaj zgjedhjeje, përcakton fatin e tij.

## Rëndësia e lirisë së zgjedhjes nga këndvështrimi praktik dhe shoqëror

Kur një individ nē shoqëri nuk ka liri të zgjedhjes pér jetën e tij, atëherë dora e shtypësve zgjatet dhe tē ligjërohet ndërsa zëri i tē shtypurve dobësohet dhe humbet mbështetjen nē ligje.

Praktika ka treguar se është me rëndësi të madhe fakti që një njeri të jetë i vetëdijshëm pér tē drejtën e zgjedhjes nē një shoqëri, sepse kjo ndikon nē ményrë tē drejtëpërdrejtë te sjellja e tij me tē tjerët. Kuptohet që sjellja e një njeriu, që e kuption vlerën e lirisë dhe rolin që ajo ka nē vendosjen e fatit tē tij, me një njeri që mendon se liria e zgjedhjes nuk ka ndikimin më tē vogël nē paracaktimin e fatit tē tij, do tē jetë krejt e ndryshme.

Mendoj se është me vlerë tē theksohet se nē jetë asgjë tjetër nuk e ndrydh më shumë shpirtin e njeriut se sa fakti që ai e ka humbur tē drejtën e zgjedhjes dhe mendon se është diçka tjetër që e komandon atë plotësisht dhe

ai është duke vepruar sipas urdhavrave tē saj pa kurrfarë rrugëdaljeje.

**Ndryshimi midis njeriut që beson tek liria e tij dhe atij që nuk ka një mendim të tillë është i madh. I pari është njëloj si ai zogu i lehtë me krahë tē hapur, i cili mund tē fluturojë kudo me dëshirën e tij, ndërsa i dyti është si ai zogu që i ka krahët e prera dhe nuk e ka privilegjin e fluturimit sipas vullnetit tē tij. Kjo gjë i shkakton dhembje tē përhershme shpirtërore.**

Përveç dëmeve personale, që shkakton mungesa e zgjedhjes së lirë te njeriu edhe dëmet shoqërore janë tē konsiderueshme. Mosnjojha e saktë e lirisë, që ekziston te njeriu, nē kuptimin e plotë tē fjalës, është si virusi që ka infektuar fillimisht vetë personin dhe me pas in-



fekton gradualisht shoqërinë. Më saktë, bën që dora e shtypësve tē zgjatet dhe tē ligjërohet, ndërsa zëri i tē shtypurve tē dobësohet dhe tē humbasë mbështetjen nē ligji.

Ata që zoterojnë pasuri tē tē tjerëve dhe pasuri tē mëdha tē përbashkëta, mbi bazën e pretekstit, se gjoja fati deshi tē ndodhje këshfu, harrojnë tē falënderojnë Zotin pér një gjë tē tillë dhe nuk u japid tē drejtë tē tjerëve pér tē protestuar dhe ngritur zërin pér një gjë tē tillë. Kjo është arsyja që njerëzit dhe vendet agresore zbatojnë diktatin e tyre mbi tē dobëtit dhe i lënë ata nē një errësirë absolute lirie. Historia islamë dokumenton shumë fakte tē tilla, ku qeveri tē ndryshme mizore dhe diktatura nga më tē shumëlojshmet janë munduar me tē gjitha mjetet që tē fshijnë nga kujtesa e njerëzimit tē drejtën themelore që njeriu ka pér tē zgjedhur.



## Të njihemi me suren Ja-Sin

### Të dhënrat e sures

Surja Ja-Sin ka zbritur në Meke, ka 83 ajete, 729 fjalë dhe 3000 shkronja.

### Emërtimi

Eshtë një prej fjalëve të veçuara dhe një prej emrave të të Dërguarit (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij).

### Arsyeja e emërimit

Eshtë ajeti i parë i kësaj sureje ku kuvendohet me profetin Muhamed (pqmtf) dhe fillon me "Ja-Sin", që është edhe fjalë e veçuar por edhe epitet i të Dërguarit të Zotit (pqmtf).

### Emrat e tjera

Zemra e Kuranit, Rejhanetul-Kuran, Dafia (larguese e të këqijave dhe e veprale të shëmtuara në jetën e njeriut), Muamame (të gjithë të mirat e kësaj jete dhe të jetës së amshuar janë të tubuara në këtë sure).

### Përbajtja e sures

- Misioni i Profetit të Islamit (pqmtf), Kurani i Madhërisëm dhe qëllimi i zbritjes së këtij libri të shenjtë (deri në ajetin e 11-të).
- Misioni i tre profetëve, ngarkuar nga Zoti dhe mënyra e ftesës së tyre për të besuar në një Zot, lufta e vazhdueshme dhe e palodhur e tyre kundër politeizmit, që është dhe një lloj kurajoje për Profetin e Islamit, Hazret Muhamedin (pqmtf) (deri në ajetin 32).
- (Nga ajeti 33 deri në ajetin 44) Shenjat e madhështisë së Zotit

në univers, si: mbirja e bimëve në tokën e vdekur, blerimi i kopshteve me pemë frutore, krijimi i qenieve çift, nata, dita dhe dielli, lundrimi i anijeve në dete dhe oqeane etj.

- Jeta e Përtejme dhe shkaqet e ndryshme të saj, si do të ndodhë dita e Kijametit, gjykimi, dita e Kijametit, Xheneti dhe Xhehenemi.
- Çështje tronditëse për zgjimin dhe vigilencën e neglizhuesve dhe atyre që nuk janë të informuar mbi të ardhmen.
- Aspekte të ndryshme të krijimit, vdekjes, jetës dhe Kijametit.
- Fati i keqbërësve dhe besimtarëve.

### Renditja e sures

Sipas renditjes së tubimit, është surja e 36-të; sipas zbritjes, është surja e 40-të e zbritur pas sures el-Xhin dhe para sures el-Furkan.

### Fillimi dhe fundi

- "Ja-Sin. Pasha Kuratin e pacenueshëm në urtësinë e tij të lartë!"
- "I lartë është Ai, e në dorën e tij Cilit është pushteti mbi gjithçka dhe vetëm tek Ai kthehem".

### Mirësia e sures

Imam Sadiku (pqmt) ka thënë: "Ai që e lexon (a e këndon) suren Ja-Sin para perëndimit të diellit, do të jetë i mbrojtur dhe fatlum gjatë gjithë ditës dhe atij që e lexon (a e këndon) çdo natë para se të flejë gjumë, i dërgohen 1000 melekë që ta ruajnë atë nga çdo djall dhe e ligë".

# Pse duhet ta duam Familjen e Profetit Ehli Bejtin?

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve! Bekimi më i mirë e paqja më e plotë qofshin mbi Muhamedin e zgjedhur e besnik dhe mbi familjen e tij të udhëzuar e të besës!

Në të vërtetë, dashuria për Ehli Bejtin, Pasardhësit e Profetit të zgjedhur, konsiderohet si një domosdoshmëri prej domosdoshmërive të padyshimta e të prera në fenë islamë, në Libër (Kur'an) dhe në traditën profetike (Sunnet). Allahu i Lartësuar thotë:

*"Nuk ju kërkoj për një gjë të tillë shpëblim, veç se dashuri për të afërmit."*

Në një hadith autentik të përcjellë nga Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), thuhet: **"Duajeni Allahun për atë që ju ushqen nga begatitë e Tij. Më doni mua për hir të dashurisë ndaj Allahut dhe duajeni Ehli Bejtin tim për hir të dashurisë ndaj meje."**

Dhe: *"Dashuria për ta eshtë shenjë besimi dhe urrejtja për ta eshtë shenjë hipokrizie."*

Dhe: *"Ai që i do ata, e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe ai që i urren ata, e urren Allahun dhe të Dërguarin e Tij."* E dhjetëra hadithe të tillë të cilat ftojnë për dashuri ndaj Ehli Bejtit dhe ndalojnë urrejtjen ndaj tyre. Ajo që s'ka dyshim, eshtë se i Lartësuar e obligoi dashurinë dhe dashamirësinë ndaj tyre përkrah obligimit të kapjes me ta, sepse ata janë familja e dashurisë dhe

e vilajetit për shkak të afërsisë së tyre tek i Lartësuar, pozitës së tyre tek Ai dhe pastërtisë së tyre prej idhujtarisë, politeizmit (shirk), mëkateve dhe prej çdo gjëje që i lagon prej mejdani të bujarisë e kënaqësisë së Tij. Për këtë, dashuria ndaj Ehli Bejtit eshtë një bindje, zanafilla e së cilës eshtë Libri i Allahut të Lartësuar dhe Sunneti i (tradita e) Profetit të Tij të zgjedhur. Dashuria ndaj tyre nuk eshtë thjesht një dashuri kalimtare apo thjesht një ndjenjë, por eshtë një princip që ka lidhje me dashurinë për udhëheqësit bartës të Mesazhit, të cilët Allahu i Lartësuar i bëri udhërrëfyes për njerëzinë pas Profetit të Tij fisnik (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

U dhuroi atyre cilësitë e përsosura si: trimëria, falja, sinqueriteti, dituria, urtësia dhe etika e morali. Ata i ka bërë porta të Tij udhërrëfyes të rrugës së Tij, bartës të diturisë së Tij, depozitë të njohurive të Tij, përcjellës të Shpalljes së Tij dhe të shtyllave të Njësimit (teuhid) të Tij. Në të vërtetë, ai eshtë një parim që lidhet me dashurinë ndaj një prej dy gjërate më të rënda, për të cilat i Dërguari ka urdhëruar umetin e tij që të kapet fort me ato të dyja deri sa të shkojnë te burimi i Keutherit. I ka bërë amanet për banorët e Tokës, ashtu siç janë amanet yjet për banorët e qiellit.

Ata janë si varka e Nuhut: ata që hipën në të shpëtuan dhe ata që kundërshtuan u mbytën e u zhdukën. Lusim Allahun e Lartësuar që t'u sjellë dobi me këtë vëllezërve besimtarë dhe ta bëjë këtë vepër të mirë për ne në këtë botë dhe pasuri në Jetën e Përtejme.

*Allahu eshtë Poseduesi i suksesit.*



Në lidhje me ndarjen dhe kategorizimin e dijetarëve  
Prijësi i besimdrejtëve Imam Aliu, paqa e Allahut qoftë  
mbi te, thotë:

“Dijetarë janë dy grupe: të parin e përbëjnë  
dijetarët të cilët veprojnë sipas dijes së tyre, dhe  
ata janë të shpëtuar, ndërsa të dytin e përbëjnë  
ata që nuk veprojnë sipas njohurive të tyre, dhe  
ata janë të dështuar. Vërtetë banuesit e xheh-  
nemit janë të shqetësuar për shkak të kutërbimit  
të dijetarit i cili nuk posedon vepra, dhe vërtetë  
pendimin dhe keqardhjen më të madhe nga të  
gjithë banuesit e xhehnem do ta ketë njeriu i  
cili tjetrin e ftont kah Zoti — qoftë i adhuruar  
Ai! dhe ky i dyti e ka pranuar thirrjen e tij dhe i  
është nënshtruar Allahut, dhe Allahu e ka futur  
në xhenet, ndërsa atë që ka bërë thirrje, për sh-  
kak të mosveprimit sipas dijes që kishte posedu-  
ar, e kishte futur në xhehnem.”

## Dijetarët sipas Imam Aliut

Në një kudsi-hadith Zoti i Madhërisëm i drejtohet  
Davudit, paqja e Allahut qoftë mbi te:

“Dënim i vogël për dijetarin i cili nuk ve-  
pron sipas njohurive që ka është më i rëndë se  
shtatëdhjetë dëname dhe vuajtje: do ta heqë nga  
zemra e tij ëmbëlsinë për të më përmendur Mua.  
(Pas çkaje më nuk do të kënaqet duke më për-  
mendur Mua.)”



# DOBITË NGA EMRAVE E BUKU

Përmes ajeteve kur'anore, Allahu i Lartësuar i mëson robërit e Tij besimtarë se me çfarë fjalësh t'i drejtohen Atij. Ja si thuhet në Kur'anin Fisnik, në suren A'raf, ajeti 180:

وَلِلّٰهِ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَى فَادْعُوهُ بِهَا وَذَرُوا الَّذِينَ يُلْحِدُونَ فِي أَسْمَائِهِ سَيُجْزَوْنَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ

## الرَّحْمَنُ

### 1. Er-Rahman (i Gjithëmëshirshmi)

Ai që reciton këtë emër 100 herë, do të ketë kujtesë të mprehtë.

## الْمَلِكُ

### 3. El-Malik (Sunduesi)

Ai që reciton këtë emër shpeshherë, do të respektohet dhe të trajtohet në përputhje me të tjerët.

## الرَّحِيمُ

### 2. Er-Rahim (Mëshirëploti)

Ai që reciton këtë emër shtatë herë, do të jetë nën mbrojtjen e Allahut.

## الْمُهَيْمِنُ

### 7. El-Muhejmin (Mbizotëruesi)

Ai që reciton këtë emër me abdes të plotë, qenja e tij e brendshme do të jetë e shkëlqyeshme dhe e ndritur.

## الْعَزِيزُ

### 8. El-Aziz (Fuqipoti)

Lexojeni 40 herë pas lutjeve të mëngjesit për 40 ditë për të qenë të pavarur nga nevoja për të tjerët.

## الْخَالِقُ

### 11. El-Halik (Krijuesi)

Recitimi i këtij emri gjatë natës do ta krijojë një engjell.

## الْمَصَوْرُ

### 13. El-Musavvir (Formëdhënësi)

Recitimi i këtij emri 21 herë do t'i ndihmojë gruas gjatë lindjes së fëmijës.

## الْبَارِئُ

### 12. El-Bari (Filluesi)

Recitimi i këtij emri 21 herë do t'i ndihmojë gruas gjatë lindjes së fëmijës.

## الْفَتَّاحُ

### 18. El-Fettah (Zgjidhjedhënësi)

Ai i cili e reciton këtë emër do të arrije dhe sigurojë fitoren.

## الرَّزَّاقُ

### 17. Er-Rezzak (Furnizuesi)

Ai që reciton këtë emër, do të ketë furnizim nga Allahu.

# R TË ZOTIT - ESMAUL HUSNA

الْقَدُّوسُ

## 4. El-Kuddus (i Pastri)

Ai që reciton 100 herë çdo ditë, do të jetë i lirë nga ankthi.

الْمُؤْمِنُ

## 6. El-Mu'min (Siguruesi)

Ai që reciton këtë emër, do të jetë i siguruar nga çdo dëm.

السَّلَامُ

## 5. Es-Salam (Paqedhënësi)

Ai që ia reciton këtë emër 160 herë një personi të sëmurë, ai do të jetë i mundur të rifitojë shëndetin e tij të mëparshëm.

الْجَبَارُ

## 9. El-Xhebbar (i Gjithëfuqishmi)

Recitimi i këtij emri ndihmon për të parandaluar nga dhuna, ashpersia apo vështirësia.

الْمُتَكَبِّرُ

## 10. El-Mutekebbir (i Madhërishmi)

Me recitimini e këtij emri para se të keni marrëdhënie me gruan, do të bekoheni me fëmijë të drejtë.

الغَفَّارُ

## 14. El-Gaffar (Gjithëfalësi)

Ai i cili e reciton këtë emër, do t'i falen mëkatet.

الْوَهَابُ

## 16. El-Vehhab (Dhuruesi)

Ai që reciton këtë emër 100 herë, pas dy rekateve namaz do t'i përmbrushen të gjitha nevojat.

الْقَهَّارُ

## 15. El-Kahhar (Mposhtësi)

Ai që reciton këtë emër, do të bëhet i abstenuar ndaj kënaqësive të kësaj bote dhe do të arrijë të fitojë paqen e brendshme.

الْقَابِضُ

## 20. El-Kabid (Shtrënguesi)

Ai i cili shkruan këtë emër në 50 pjesë të ushqimit (fruta, bukë etj.) për 40 ditë, do të marrë ushqim të mjaftueshëm.

الْعَلِيمُ

## 19. El-'Alim (i Gjithëedituri)

Ai që reciton këtë emër do të bëhet i ndritur dhe mund të zbulojë drithën hyjnore (nur).

# Imam Bakiri

i shkëlqyeshmi shigjetarë

**Ne jemi familje tek e cila është përsosur feja dhe është plotësuar mirësia, pikërisht siç thotë ajeti:  
Sot ua përsosa fenë tuaj...**

**Ne këtë e trashëgojmë njëri pas tjetrit (velajeti dhe imamati), dhe bota kurrë nuk do të mbetet pa një person të tillë (dëshmi e Zotit).**



Në pallatin e Hishamit sunduesit të asaj kohe, kishte ulema (dijetarë) me autoritet, dijetarë dhe oratorë që Hishami shpesh i tubonte dhe caktonte një diskutim publik në pallat. Mirëpo, pasi që në pallatin e sundimtarëve emeivit – e kështu edhe në pallatin e Hishamit – kryesisht nuk kishte dijetarë të tillë, por vendin e tyre e kishin zënë tregimtarë dhe poetë të cilët sundimtarëve u këndonin oda, Hishami në asnjë mënyrë nuk e kishte ndërmend të organizonte një tubim të tillë. E dinte shkëlqyeshém që në një rast të tillë askush nga oborrtarët e tij në shqyrtime nuk do të mund t'i rinte përballë Imam Bakirit, a.s., dhe përkëtë arsy vendosi që kësaj çështjeje t'i qasej në mënyrë tjetër, atë e cila, siç kishte menduar, atij do t'ia siguronte fitoren.

Dhe kësijoj, sado kjo të ishte e çuditshme halifa Hisham vendosi të organizonte garë në shigjetari! Kishte parashikuar që Imam Bakiri a.s. do të merrte pjesë në këtë garë, bile kishte pritur që pas disfatës në atë garë Imami do ta humbaste përkrahjen në popull! Prandaj, para se Imami, të arrinte në pallat të halifit, Hishami urdhëroi disa oborrtarë të vendosnin shënjestrën dhe të fillonin të gjuanin me shigjeta. Imam Bakiri, a.s., arriti në pallat dhe për një kohë qëndroi i qetë në vendin e tij. Atëherë Hishami iu afroa dhe i tha:

**“A dëshironi të merrni pjesë në garën e shigjetarisë?”**  
Imami iu përgjigj: - “Më vjen keq, por unë jam plak dhe kanë kaluar kohët kur isha marrë me shigjetari.” Mirëpo Hishami ngulte këmbë, insistonte dhe e shtinte në be, ndërsa njëkohësisht i dha shenjë njërit nga dinjitarët emevitë t'ia linte në dorë Imamatit harkun dhe shigjetën. Imami, a.s., zgjati dorën e mori harkun, vendosi në të shigjetën, shënjestroi dhe qëlloi pikërisht në mes të cakut. Mandje vendosi shigjetën tjetër në hark, gjuajti dhe shigjeta e qëlloi atë të mëhershmen dhe e ndau përgjysmë. Shigjeta e tretë sérish e qëlloi të mëparshmen. Dhe

kësijoj nëntë shigjeta rresht qëlluan dhe ndanë përgjysmë atë të mëparshmen.

Kjo ngjarje e pazakontë ndikoi në të gjithë të pranishmit, nga të gjitha anët u dëgjuan brohorima mahnitëse dhe mbështetëse. Hishami, tanë kur llogaritë e tij ishin shthurur dhe kishin rënë në ujë, edhe vet ishte mahnitur, dhe mbasë kundër dëshirës së tij tha:

**“Urime, o Ebu Xhafer, o babi i Xhaferit! Je shigjetari më i mirë në mesin e Arabëve dhe jo-arabëve! Ndërsa deklarove që ishe plakur!?”**

Mandej Hishami uli kokën dhe për një kohë heshti. Pastaj Imam Bakirin dhe djalin e tij të nderuar i uli pranë vetës në një vend të veçantë duke treguar nderim të jashtëzakonshëm për t'i thënë Imamatit:

**“Duke iu falënderuar asaj që të kanë ty, Kurejshët meritojnë përparësinë mes Arabëve dhe joarabëve. Kush të ka mësuar që të gjuash kësijoj dhe sa gjatë ke ushtruar shigjetarin?”**

Imami, a.s., u përgjigj:

**“E di që në mesin e Medinasve është zakon marrja me këtë. Kështu edhe unë në rini për një kohë kisha interesim, ndërsa më vonë e braktisa. Por sot, pasi aq shumë ngule këmbë, pranova të gjuaja.”**

Hishami mandje pyeti:- “A është edhe Xhaferi, biri yt i shkathët në shigjetari sikur ti?”

**Ne jemi familje tek e cila është përsosur feja dhe është plotësuar mirësia, pikërisht siç thotë ajeti: Sot ua përsosa fenë tuaj... Ne këtë e trashëgojmë njëri pas tjetrit (velajeti dhe imamati), dhe bota kurrë nuk do të mbetet pa një person të tillë (dëshmi e Zotit).”**

*Marrë nga Libri :  
Muhammed ibn Xherir ibn Rustam Taberi, Dela'ilul-imamet,  
Menshurati-haydarije, Nexhef 1383, faqe 105*



## Këshilla martesore *për lumburi bashkëshortore*

### *Hotelet dhe sallat e kushtueshme*

Imam Ali Khamenei thotë: "Lérini hotelet, sallat dhe festat e kushtueshme. Një festë normale mund të bëhet edhe në një sallë të zakonshme. Sigurisht që nuk është fjalë për t'ua imponuar mendimin tonë, por të paktën shmanagni shpërdorimin e tepërt. Gëzimi dhe festimi me të afërmit dhe shokët është një gjë e mirë, kurse shpërdorimi dhe shpenzimi i tepërt është diçka e keqe që nuk u shkon përshtat muslimanëve."

**Dhe:** "Martesa dhe gëzimi është diçka e mirë. Edhe Pejgamberi më i nderuar, (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij) mbi të dhe mbi familjen e tij!), e ka festuar martesën e vajzës së tij të bekuar Fatime Zehras ( paqja qoftë mbi të) ka lexuar njerëzve poezi dhe ka duartrokitur gratë kur ato festonin. Por teprime nuk duhet të ketë në gëzimin e martesës.

**Dhe:** "Teprimet zakonisht bëhen në ceremonitë e aktit të martesës, të cilat zhvillohen në salla luksoze tepër të shtrenjta. Në këto ceremoni shpenzohet shumë. Ushqimet dhe frutat derdhen dhe shkojnë dëm dhe për çfarë? Për hir të rivalitetit e të dukjes."

**Dhe:** "Nuk duhet të bëhen shpenzime të tepërtë. Nëse vepron ju do të dëmtoni vetat tuaja po ashtu edhe të rinjtë e të rejet. Me këtë veprim ju e keni nënveftësuar veten tuaj në sytë e Pejgamberit të Islamit dhe në sytë e Imamit Zaman (imam Mehdi). Shpenzimi i tepërt kon siderohet një vepër e ndaluar."

**Dhe:** "Martesat e lumturë nuk kanë lidhje me shpenzimet e mëdha. Martesat e lumturë janë ato që bazohen te parimet islame dhe që ndërtojnë marrëdhënie të ngrohta reciproke. Ceremonia e martesës është ajo kur miqtë dhe të afërmit mblidhen në njëren prej dhomave të shtëpisë, kurse ceremonitë e mëdha të cilat zhvillohen

nëpër salla hotelesh me shpenzime të larta nuk janë të përshtatshme. Ato nuk e prishin martesën, por ato turbullojnë atmosferën e shoqërisë."

**Dhe:** "Në të shkuarën shpenzimet e tepërtë dhe ceremonitë martesore nuk zhvilloheshin në salla luksoze. Çështje të tillë nuk kanë ekzistuar fare. Njerëzit festonin në një ose dy dhoma duke ngrënë embëlsira. Askush nuk mund të thotë se ato martesa kanë qenë më pak të bekuar se martesat e ditëve të sotme.

**Dhe:** "Edhe vajzat nuk kërkonin ceremoni me shpenzime të tepërtë. Nuk ka asgjë të keqe edhe nëse ceremonitë martesore organizohen në salla të mëdha. Unë nuk i refuzoj ato salla, por refuzoj shpenzimet e tepërtë dhe të panevojshme."

**Dhe:** "Sa më të thjeshta t'i bëjmë ceremonitë, aq më mirë është. Lérini të qetë ata që i kanë mundësitë e kufizuara që të guxojnë të martohen dhe mos i bëni ata që t'i godasë dëshpërimi."

### *Sallat nuk e shtojnë dinjitetin dhe nderin*

Imam Ali Khamenei thotë: "Një pjesë e njerëzve mendojnë se formalitetet dhe shkuarja nëpër hotele luksoze e salla të shtrenjta dhe shpenzimet e mëdha janë gjëra që ia shtojnë nderin, dinjitetin dhe prestigjin djalit apo vajzës. Kurrsesi jo! Lavdia, dinjiteti dhe prestigji i djalit apo i vajzës janë devotshmëria, dëlirësia dhe jo këto gjëra të kota."

**Dhe:** "Dijeni mirë se thjeshtësia në martesë nuk është turp. Disa mendojnë se në qoftë se djalit apo vajzës i bëjnë një ceremoni të thjeshtë martese, ajo do të poshtërohet. Kurrsesi jo! Ajo nuk poshtërohet por ju e keni gabim."

## *Lehtesimi i çështjes së martesës*

**Imam Ali Khamenei thotë:** "Unë i këshilloj të gjithë njerëzit në të gjitha anët e botës që ta thjeshtojnë e ta lehtesojnë çështjen e martesës. Një pjesë e njerëzve e ndërlikojnë e martesës. Prikat e shtrenjtë dhe sendet e kushtueshme e bëjnë martesën problematike. Përse familjet e djemve kërkojnë sende të kushtueshme? Përse i hiperbolizojnë familjet e vajzave sendet e martesës dhe ceremoninë e kurorëzimit (nikahut)? Vallahi, e bëjnë përgarim me të tjerët? Përse? A e kuptojnë se këto mund të krijojnë probleme deri aty sa shumë djem apo vajza të mos mendojnë më përmartesë?"

Ai, gjithashtu, thotë: "A janë më të lumtur ata që kanë pasur një martesë të mbushur me luks dhe shpenzime se ata që janë martuar në mënyrë të thjeshtë? Shpenzimet e tepërtë nuk mbjellin gjë tjetër, veç trishitim në zemrat e atyre të rinjve që nuk kanë mundësi ekonomike përmësuar ceremoni të kushtueshme. A është normale që të rinjtë e të rejet që sapo kanë mbaruar studimet, apo që fitojnë pak, të mbeten pa u martuar vetëm se nuk arrijnë të bëjnë ceremoni të shtrenjtë?

**Dhe:** "Unë mendoj se ata që ua vështirësojnë gjërat të tjerëve nëpërmjet shpenzimeve të mëdha, nëpërmjet prikave dhe mobiljeve shumë të shtrenjtë, do ta kenë shumë të vështirë llogarinë tek Allahu i Madhëruar. Ata nuk mund të thonë se ne mund të bëjmë ç'të duam me pasuritë tona. Kemi pasuri dhe duam të bëjmë atë çfarë duam me pasuritë tona. Posedimi i pasurisë nuk është justifikim. Njeriu i pasur nuk ka të drejtë të sillet në një mënyrë që të tjerët nuk mundon ta bëjnë. Persona të tjerë të cilët nuk i kanë mundësitë ekonomike, persona që nuk e dëshirojnë diçka të tillë, persona që nuk janë të bindur përmartuar, ose persona që kanë nijet të ndryshëm, të mbeten pa u martuar?!"

## *Mbështetja e nevojtareve*

**Imam Ali Khamenei thotë:** "Mos shpenzoni shumë dhe mos e teproni. Mos i bëni këto vepra, sepse nuk janë në interes të askujt. Edhe Allahu i Madhëruar nuk e pëlqen këtë gjë. Dije mirë se ti vështirëson veten tënde, prandaj në vend të këtyre shpenzimeve të mëdha, jepja një të dhjetën e saj një nevojtari që të marrësh një sevap."

**Dhe:** A do të jetë më e bukur ceremonia juaj nëse ju dëshironi ta bëni martesën në një hotel luksoz, të shpenzoni shumë, të shërbeni frutat e freskëta të kohës etj?! Në mënyrë kategorike ajo nuk do të ketë asnjë shpërbirim nga Zoti. Dijeni mirë se kjo nuk ka asnjë shpërbirim tek Allahu i Lartësuar, sepse shpërdorimi i tepërt është gjynah. Në mënyrë kategorike në të nuk ka asnjë shpërbirim dhe asnjë sevap. Me këto veprime ju vetëm se privoni qindra të rinj e të reja nga ceremonia martesore vetëm sepse ato nuk i kanë mundësitë ekonomike të bëjnë shpenzime si ju."

## *Ndigni pasardhësit e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij)*

**Imam Ali Khamenei thotë:** "Një nga gratë më të mira të botës është e nderuara Fatime Zehra s.a., kurse burri dhe bashkëshorti më i mirë në botë është prijesi i besimtarëve, Aliu. Shikojeni me kujdes se si u martuan ata të dy? Mijëra djem impatikë dhe me prejardhje të mirë, të fuqishëm e të dashur, nuk i afrohen as te maja e flokut prijesit të besimtarëve, Aliut ibn Ebi Talibit. Mijëra vajza të bukura dhe të vlerësuara nuk i afrohen asnjë fije floku Fatime Zahrasë. Këta të dy kanë qenë prej njerëzve me pozitë tek Allahu i Madhëruar dhe prej njerëzve të mëdhenj të kohës së tyre. Fatimeja ka qenë vajza e të Dashurit të Zotit, kryetarit të ymetit islam dhe udhëheqës i tij, kurse Aliu ka qenë luftëtari (el muxhahidu) i parë në Islam. Shikojeni se si u martuan këta të dy. Ata patën një prikë të vogël. Përgatitja e dasmës ishte e thjeshtë. Çdo gjë është bërë në emrin e Allahut dhe duke përmendur Allahun. Këta janë shembulli ynë përmartuar!

Edhe në atë kohë ka pasur injorantë, të cilët e tepronin në prikën e vajzave të tyre dhe e vlerësonin, përmartuar! me një mijë deve. Po a ishin vajzat e tyre më të mira se vajza e Pejgamberit s.a.a? Prandaj, këta njerëz mos i imitonitë në traditë dhe ndiqni vajzën e Pejgamberit, ndiqni prijesin e besimtarëve

## *Veshja e dasmës*

**Imam Ali Khamenei thotë:** "Disa njerëz blejnë rroba shumë të shtrenjtë natën e dasmës. Kjo nuk është e nevojshme. Nëse kanë nevojë përmësuar kostum dasme, le të shkojnë ta marrin me qera. A mos është turp kjo gjë? Jo, këtu nuk ka gjë përmartuar! Po çfarë i pengon atëherë? Një pjesë e njerëzve mund të mendojnë se kjo është e turpshme. Turp dhe e metë është që pasuritë e njerëzve të shkojnë dëm duke blerë një gjë që e përdor vetëm një herë dhe pastaj e hedh tutje. Shpenzime të tillë bëhen në një kohë që plot njerëz janë vërtetë në nevojë".

## *Prika është simboli i dashurisë*

**Imam Ali Khamenei thotë:** "Pejgamberi Muhammed s.a.a, e shkatërrroi traditën e prikës së kohës së injorancës. Personi që e bëri të ligjshme prikën është Pejgamberi më i nderuar. Ai është krijesa më e përsosur. Vajza e tij e pastër dhe e dashur është një prej grave më të mira të botës, kurse burri i saj është prijesi i besimtarëve dhe krijesa më e mirë pas Pejgamberit s.a.a. A e keni vënë re sesa e përcakttoi prikën Pejgamberi s.a.a., përmartuar! dhe kishin një pozitë të lartë, ishin të dy persona të modëlit të parë në Medine?"

**Dhe:** "Pejgamberi s.a.a. i shkatëroi ato gjëra, sepse i pengonin djemtë dhe vajzat për t'u martuar. Në martesë, e rëndësishme është që të merren në konsideratë aspektet njerëzore dhe humanitare."

**Dhe:** "Mos mendoni se prikat e larta dhe mobiljet e shtrenjta nuk kanë qenë të mundshme që në atë kohë. Edhe në atë kohë ka pasur njerëz të palogjikshëm, njësoj si në kohët tona, të cilët e caktonin prikën shumë të lartë, me 40 flori, për vajzat e tyre. Këto veprime të ekzagjeruar që në origjinë janë prej veprave të injorantëve, Islami erdhi dhe i fshiu totalisht ato. A nuk mund të thoshte Pejgamberi s.a.a., se prika e vajzës sime duhet të jetë njëmijë deve të kuqe me specifikime si të donte ai?! Ai mund ta bënte këtë, mirëpo Islami erdhi dhe i anuloi të gjitha ato çështje."

**Dhe:** "Prika e shtrenjtë është pjesë e periudhës së injorancës. Pejgamberi më i nderuar, e ka anuluar atë. Pejgamberi Muhamed s.a.a., ka qenë prej familjeve më të rëndësishme të kohës. Familja e Pejgamberit s.a.a., rriddhite nga një prej fiseve më të rëndësishme kurejshe dhe ai vetë ka qenë kryetar dhe udhëheqës i shoqërisë. Atëherë ç'problemi do të ishte nëse prika e vajzës së tij,

e cila vinte nga një familje e tillë të ishte e shtrenjtë, përmë shumë që ajo ishte gruaja më e mirë e botës. Pozita e saj ishte aq e lartë sa Allahu i Madhëruar e bëri atë zonjë të grave të botërave, nga të parat dhe të fundit e kohës. Atëherë, përsë e pakësoi prikën për këtë vajzë Pejgamberi s.a.a.? Ajo prikë u quajt "prika e traditës".

**Dhe:** "Unë mendoj se ruajtja e thjeshtësisë së përgatitjes së prikës deri në këtë shkallë, edhe kur bëhej fjalë përlulen më të nderuar Fatimen kishte për synim të jepte modelin për të gjithë Ehli Bejtin e Pejgamberit s.a.a. Ai me këtë prikë të pakët, "prikën e traditës" donte t'u jepte modelin njerëzve që të mos shpenzonin pa kufi. Megjithëse njerëzit e dinin se mund t'i shtonin diçka "prikës së traditës", ata e ruajtën me kujdes këtë standard. Unë mendoj se "prika e traditës" ishte simbolike, ishte një standard i arritshëm nga të gjithë. Kjo ishte bërë që njerëzit të mos përballen me shpenzime të tepërtë, të cilat për një pjesë ishin të paaritshme".

*Marrë nga Libri*


*Titulli: 101 këshilla për lumturinë bashkëshortore*

*Autori: Sejjid Ali Khmenei*




# Thënie të Imam Aliut

në lidhje me të vërtetën dhe gënjeshtrën



- Gënjesh tari dhe i vdekuri janë të barabartë, pasi përparësia e të gjallit ndaj të vdekurit është besimi në të gjallin dhe kur të gjallit nuk i besohet fjala, në të vërtetë jeta e tij shkon e humbur.
- Shpata në dorën e trimit, që godet në shenjë, nuk është më e fuqishme se e vërteta.
- Nëse je i vërtetë - të shpërblejmë dhe nëse je gënjeshtar - të dënojmë.
- Mos bëj pabesi me besën e dhënë, mos e prish premtimin e bërë dhe mos e mashtro armikun tënd.
- Kujt i mungon e vërteta në logjikën e tij, ai pëson dhembje në moralet më të nderuara.
- Fjala e mirë është ajo që e vërtetojnë veprat.
- Gënjeshtra nuk vlen as pér seriozitet, as pér shaka, as që ndonjë prej jush t'i premtojë fëmijës së tij dhe pastaj të mos e mbajë premtimin që i bëri. Gënjeshtra çon në mëkate.
- Qëndroni larg gënjeshtrës, sepse e vërteta qëndron mbi shpëtimin dhe mbi respektin, kurse gënjeshtra qëndron në buzë të greminës e të shkatërrimit.

# Të folurit e fjalëve të turpshme



*"Besimtari (mu'mini) nuk tallet, nuk kritikon, nuk fajeson dhe nuk flet keq për të tjerët"*

Përdorimi i fjalëve të këqija dhe të folurit e fjalëve të turpshme është një shprehi e keqe. Personat që i përdorin sharjet duke folur çfarëdo që u bie ndërmend, rrallë u përbahen fjalëve të folura. Ata e ndryshojnë shumë shpesh mendjen e tyre. Ata i përdorin fjalët e këqija dhe i gjejnë të metat e të tjerëve pa pasur ndonjë arsyë për këtë. Ata u shkaktojnë lëndime të tjerëve përmes fjalëve të tyre të papërgjegjshme. Përdorimi i fjalëve të këqija është haram dhe konsiderohet një mëkat i madh.

I Dërguari i Islamit, ka thënë:

"Allahu ua ka ndaluar Xhenetin atyre që i përdorin lapërdhittë. Po ashtu, ekziston edhe mallkimi ndaj atyre që shajnë, që janë të paturpshëm dhe të pafytyrë, dhe atyre do t'u ndalohet hyrja në Xhenet. Çkado që personat e tillë flasin për të tjerët, e bëjnë këtë pa penduar dhe asnjëherë nuk mërziten për atë se çfarë mendimi kanë të tjerët për të" (Usul el-Kafi, vëll. 2, f. 323).

Imam Xhafer Sadiku ka thënë: "Mallkimi, sharja dhe paturpësia janë shenjat e hipokrizisë (nifik) dhe të pabesimit" (Usul el-Kafi, vëll. 2, f. 325).

Allahu thotë në Kuranin e Shenjtë:

"Mjerë për ata që flasin për dobësitet e të tjerëve dhe kënaqen duke i përqeshur të tjerët" (Surja el-Humeze, ajeti 1).

Personat që i përdorin sharjet, në përgjithësi janë inferior dhe mendjengushtë. Ata i përsitojnë armiqëtë përmes të folurit të tyre të pamatur. Njerëzit i urrejtnë ata. Ata mundohen të rrinë larg prej tyre dhe i shmanget sho-

qërimit të tyre. I Dërguari i Islamit, ka thënë: "Më i keqi ndër njerëzit është ai, fjalët e të cilit nuk pëlqehen nga të tjerët dhe nga takimi i të cilit i shmanget" (Usul el-Kafi, vëll. 2, f. 325).

Imam Xhafer Sadiku, ka thënë: "Kur njerëzit nuk duan as t'i dëgjojnë fjalët e një personi, fati i tij do të jetë Xhenenemi?" (Usul el-Kafi, vëll. 2, f. 327).

I Dërguari i Islamit, ka thënë: "Besimtari (mu'mini) nuk tallet, nuk kritikon, nuk fajeson dhe nuk flet keq për të tjerët" (El-Mehajjat el-Bejda, vëll. 3, f. 127).

Sipas natyrës, fëmija nuk është i prirë përfjalët e turpshme. Ai mund ta mësojë këtë prej prindërve, vëllezërve, motrave, shokëve dhe duke luajtur në shkollë. Por, ndikimi më i madh do të jetë prej qëndrimit të prindërve. Prindërit mund të janë shembulli më me ndikim përfémijet. Prindërit jo vetëm që janë përgjegjës për sjelljen e tyre, por kanë përgjegjësi shumë të rendësishme përftrajnimin e duhur të fëmijëve të tyre. Prindërit janë ata që ose i bëjnë fëmijët të sjellshëm e të butë, ose të pafytyrë. Disa prindëri, duke bërë shaka apo kur janë të zemëruar u flasin fëmijëve të tyre fjalë të këqija. Në këtë mënyrë, ata u japid një trajnim të gabuar fëmijëve të tyre. Janë disa shtëpi ku përdorimi i fjalëve të këqija është praktikë e rendomtë.


'Biri i qenit', 'nëna e qenit', 'idiot', 'budalla', 'gomar i pandjenjë', 'shtazë', 'i paturp' dhe disa fjalë të tjera janë emrat që i emërtojnë njëri-tjetrin personat e shtëpisë gjatë bërjes së shakasë apo gjatë zemërimit.

Prindërit, detyra e tē cilëve është parandalimi i gabimeve të fëmijëve të tyre, vetë janë duke kryer vepra të tilla të gabuara dhe duke i inkurajuar fëmijët që ta ndjekin shembullin e tyre. Ata e fyejnë dhe e shajnë njëri-tjetrin përpara fëmijëve, pa menduar për pasojat.

Prindërit i përqeshin fëmijët dhe e përdorin gjuhën e pamoralshme me ata. Si mund të presin prindërit e tij që fëmijët e tyre të rriten në persona miqësorë dhe të respektuar. Ata duhet të kuptojnë se fëmija mund të tregohet edhe më i keq sesa vetë ata. Ata duhet të mbajnë në mend se herët apo vonë do të shohin se fëmija është duke e përdorur gjuhën e njëjtë që e ka dëgjuar sa e sa herë prej prindërve të tij. Pastaj, asnjë sasi e predikimit apo e rrahjes nuk mund ta reformojë fëmijën. Mjeti më i mirë i shërimit është që prindërit së pari ta reformojnë me kohë vetveten para se të bëhet tepër vonë.

Shumë herë, fëmija e mëson këtë shprehi të keqe prej shokëve të tij. Prindërit duhet t'i mbajnë të hapur sytë dhe veshët e tyre ndaj sjelljeve të tillë te fëmijët e tyre dhe ta evitojnë para se të lëshojnë rrënjen. Ata duhet të kërkojnë prej fëmijëve të tyre që të mos shoqérohen shumë me fëmijët e tillë.

Nëse vëreni se fëmija juaj është duke i shqiptuar fjalët e tillë fyeze, atëherë mos qeshni dhe mos rrini të qetë. Edhe përmes britmës dhe kërcënameve situata e tillë nuk mund të tejkalohet. Kjo metodë mund të dështoje. Mënyra më e mirë për të korriguar fëmijën është biseda e butë me fëmijën dhe shpjegimi për efektet e këqija të përdorimit të fjalëve të këqija.



# Pranimi i mosdijes, veti e dijetarëve hyjnor

Pejgamberi Fisnik, paqja e Allahut qoftë me të dhe familjen e tij të ndershme, në hadith thotë:

“Kushdo që fiton njohuri të cilat duhet të arrihen vetëm pér hir të Allahut, por, e fiton vetëm pér hir të pozitës dhe qëllimit në këtë, nuk do ta ndiej aromën e xhenetit në Ditën e gjykimit.”

“O Ebu Dherr, sa herë të pyetesh pér diçka që nuk e di, thuaj: ‘Këtë nuk e di’ do të shpëtosh nga pasojat e saj, dhe mos gjyko pér njerëzit pér atë që nuk e di — do të shpëtosh nga dënimini i Zotit në Ditën e gjykimit.”

Është e pahijshme që njeriu ta thotë atë që nuk e di, sepse shpesh ajo që thotë mund të jetë shkas pér mashtrimin dhe humbjen e rrugës njerëzve të tjera. Një nga telashet e mëdha që mund ta godas dijetarin është që, nëse nuk di diçka, ka turp dhe nuk dëshiron ta pranoj padijen e tij. Të pranosh mosdijen është lehtë pér të padijshmin, por kur dikush njihet si njeri i ditur, atëherë përpinqet t'i shmanget shqiptimit të fjalës: “Nuk e di.” Kur e pyesin pér diçka që nuk di, e ka vështirë të mos përgjigjet në pyetje, sepse ka frikë që njerëzit do t'i thonë: “Çfarë dijetari je ti kur nuk di të përgjigjesh në pyetje?”

Pse duhet të jetë e vështirë që njerëzve t'i përgjigjet: “Nuk e di”? A është bërë obligim fetar ajo që të gjithë t'i dinë të gjitha? Vetëm Zoti i di të gjitha dhe të tjerëve u ka dhënë

dije nga dija e Tij sa një pikë, siç thuhet në Kur'anin Fisnik:

“...e juve ju është dhënë  
fort pak dije”.

## Rahmetliu Alame Tabatabai Allahu qoftë i kënaqur me të!

Të mërkurave dhe të enjteve mbante ligjëratë të cilat ndiqeshin nga një numër i konsiderueshëm nxënësish. Aty shqyrtoheheshin çështje filozofike dhe të tjera. Kur kishin ndonjë pyetje, para fillimit të ligjëratës apo në rrugë, nxënësit e ndalnin dhe ia parashtronin pyetjet e tyre. Një natë në rrugë ia shtrova një pyetje filozofike, ndërsa ai u përgjigj se nuk e dinte. Ia shtrove edhe pyetjen e dytë, ndërsa ai pa hezitim u përgjigj se nuk e dinte. Mandej u mendua pak dhe më tha: “Shikoni, edhe në këtë mënyrë njeriu mund të përgjigjet.” Pastaj ofroi përgjigje të kënaqshme, bindëse. Ai atë natë tha: “Atë që ne nuk e dimë duhet ta krasojmë me dijen e Zotit. Vetëm atëherë do ta kuptojmë që nuk dimë asgjë dhe që ajo të cilën nuk e dimë është e paskajshme ashtu siç është e paskajshme dija e Zotit.”

Ky është veprim i atyre të cilët janë edukuar në shkollën e pejgamberëve të Allahut dhe dinjitarëve, të cilët me mëdyshje përgjigjeshin në pyetjen për të cilën nuk kishin përgjigje të sigurtë. Shpesh, përgjigja të cilën e jepte Alame Tabatabai ishte më e sigurtë se ajo për të cilën ne ishim të sigurtë, por nësë se ai nuk kishte njohuri dhe siguri për atë që mendonte, metoda e tij ishte që në fillim të thoshte: "Nuk e dil!" Në të vërtetë, kjo mënyrë është krijuar si fryshtësi i përpjekjes me shpirtin (nefs) dhe mposhtja e tij.

Kjo është rruga dhe mënyra e atyre të cilët gjashtëdhjetë vjet apo shtatëdhjetë të jetës së tyre përplot mirësi në rrugën e pastrimit të shpirtit, nxënies dhe të mësuarit. Sot, kur ne mësojmë disa fjalë dhe terme dhe shkojmë në qytetin tonë e na pyesin diç, e kemi vështirë të themi se nuk e dimë. Duhet thënë lirisht: "Nuk e di." Nëse nuk jemi të sigurtë në diçka, të themi: "Ka mundësi të jetë kështu." Në atë rast e kemi çliruar vetveten nga telashet në atë Botë.

### **Shkaku më i madh i pendesës së dijetarit në Ditën e Gjykimit**

"O Ebu Dherr, një grup banorësh të xhenetit do të jetë sipër banorve të xhehnemit dhe do t'i pyes: 'Çka ju ka futur në zjarr, ndërsa ne kemi hyrë në xhenet duke iu falënderuar edukimit dhe mësimeve që kemi marrë nga ju?' Këta do të përgjigjen: 'të tjerët i kemi urdhëruar të bëjnë veprat e mirë, ndërsa vetë nuk i kemi bërë.'"

Një nga skenat e ditës së gjykimit, e cila pasqyrohet në Kur'an, është që banuesit e xhenetit gjenden sipër banuesve të xhehnemit; i shohin dhe bisedojnë me ta, sikur xheneti të jetë në një vend të lartë, ndërsa xhehnemi poshtë. Dhe në këtë mënyrë banuesit e xhenetit janë sipër banuesve të xhehnemit. Kur'ani përshkruan se si dikur banuesit e xhenetit u drejtohen banuesve të xhehnemit, ndërsa ndonjëherë e kundërtë, banuesit e xhehnemit u drejtohen banuesve të xhenetit:

**Edhe banuesit e xhenetit do t'i ftojnë banuesit e Zjarrit:  
"Ne e kemi marrë të vërtetë atë që na e është premtuar nga Zoti ynë. E ju a e gjetët vërtetë atë me çka ju pat kanosur Zoti juaj?" Dhe banuesit e Zjarrit do të përgjigjen: "Po!" Atëherë një zëdhënës**

midis krejt atyre do të kumtojë: "Mallkimi i Allahut qoftë mbi ata që kanë kryer veprat e këqija".

Në të vërtetë, në harmoni me atë që është shënuar në transmetime, banuesit e xhenetit i thonë një grupi të banuesve të xhehnemit: Duke iu falënderuar udhëzimeve dhe bekimit të mësimeve tuaja dhe edukimit e kemi gjetur rrugën deri në xhenet. Çfarë ndodhi të ndëshkoheni ju me xhehnem dhe dënim të Zotit? Ata do të përgjigjen me pendesë dhe keqardhje: Ne nuk kemi vepruar sipas asaj që kemi folur: juve ju kemi ftuar të bëni veprat e mira dhe me vlerë, por vetë nuk i kemi bërë ato. Iu kishim bërë juve thirrje që të bëni veprat falënderuese, ndërsa vetë nuk i kishim bërë ato; ne ju kemi udhëzuar juve të largoheni nga mëkatet dhe shpifjet, por vetë jemi përlyer me mëkatet dhe shpifjet. Ju i keni dëgjuar fjalët tona dhe keni vepruar sipas tyre dhe kësisoj u vendosët në Shtëpinë e përjetshme, ndërsa ne nuk kemi vepruar sipas dijes që kishim dhe u goditëm nga ky fat i turpshëm dhe i dhëmbshëm.

Ky shpjegim dhe kjo keqardhje është fundi i atyre që nuk veprojnë sipas njohurive të tyre. Sigurisht që kjo keqardhje përtetet e kështë më e dhembshme se djegia e zjarrit të Allahut, sepse vuajtjet shpirëtrore janë më të dhembshme se ato fizike. Dhembja që e shkakton keqdashja e armikut është më e madhe se dhembja e shkaktuar nga vuajtja vetanake dje.

Është e dhembshme që njeriu ndjen që të tjerët nespërmjet udhëzimeve të tij e kishin gjetur rrugën deri në xhenet, ndërsa ai edhe pse ka mundur që me mundësitet e tij të arrinte shkallë më të lartë ka rënë në vuajtjen e xhehnemit dhe tanë nxënësit e tij rrinë dhe e shikojnë! Ata kënaqen në xhenet, e ai përpelletet në xhehnem. Sikur ai të mos kishte asnje vuatje tjetër, përvçe këtij privimi nga mirësitet që kishin arritur ata të cilët i kishte edukuar, do t'i mjaftonte.

Po vëmë re pikëpamjet të cilat pasqyrohen në këtë hadith, konstatojmë që ne së pari duhet që qëllimet tona t'i bëjmë të drejta dhe të pastra, që duhet të nisemi në rrugë të fitimit të dijes përfundimtare të Zotit dhe drejt zbatimit të obligimeve. Që nga fillimi duhet ta bëjmë atë që e themi, që kjo veçori të bëhet veti e jona konstante (meleke), e nëse ia dalim të arrijmë në njohuri më të mëdha, të mund të veprojmë sipas tyre. Nëse që në fillim tregohemi sipërfaqësor dhe elastik, nëse në fillim e lëmë zbatimin e ndonje obligimi, e mandej edhe të tjerat dhe kësisoj lejojmë që brenda nesh të forcohet ndjenja e rebelimit, beteja e tutjeshme me vetveten do të bëhet e vështirë dhe e paqartë.

# Francezja cifute që pranoi fenë Islame



Unë jam nga Franca, nga një familje jo fetare me pre-jardhje cifute (nuk janë të denjë ndaj fesë dhe mund të them se ata janë ateistë). Kam pasur familje rigoroze, me virtute të forta morale. Vetë kam qenë person shpirtërorë. Kam vëllezër dhe motra më të vegjël se unë, ndoshta kjo është arsyja se mua më është dhënë më shumë qasje, në moshën 15 vjeçare sidomos në mendjen time ka filluar një interesim i madh ndaj Zotit dhe njohjes së Tij. Në fillim pata filluar me Biblat që i kishte rënë pluhuri në raftin e librave të shtëpisë sonë. Pasi që nënën e kisha ortodokse, kurse babin çifut mirëpo asnjeri nuk ishin të dhënë dhe të devotshëm ndaj fesë dhe Zotit. Duke lexuar Biblën në fillim ndjeva plotësimin në shpirt dhe ndjeva atë ndjenjën se isha në rrugën e drejt. Pas disa vitesh në moshën 18 vjeçare mu dha mundësia ta vizitoja Izraelin dhe tokën e bekuar të Jerusalemit në një seminar ku isha e ftuar si një ortodoks-cifute. Atje e dhashë maksimumin dhe iu dorëzova Zoti, pa asnjë dyshim. Gjatë kohës që isha atje njoha arab-palestinez, duke qenë se gjithnjë isha e brengosur ndaj njerëzve në vuajte dhe mjerim, duke i parë ata ndihesha shumë e mllafosur me ta por njëkohësisht e mllafosur edhe me besimtarët e fesë sime. Sepse diçka më habiste sepse mediat në këtë vend nuk i tregonin ato çfarë shihja në shtetin tim në Francë. Dëgjoja ezanin, më pëllqente edhe pse nuk e kuptoja. Dhe kur për herë të parë ndjeja dy gjëra në të njëjtën kohë, lehtësim dhe frikë. Frikë nga ajo që ndoshta po bëja mëkat dhe lehtësim përmes mua dhe përmes gjithë ata palestinez që mbi të gjitha vuajtjet që kishin po i jepnin rëndësi himnit të tyre përmes ta kënduar bukur.

Unë nuk doja ta zgjidhja fenë time duke shikuar se ku dhe çfarë është e drejtë por ku është e vërteta. Vizitova kushëritën time që ishte duke jetuar afér pjesës së palestinezëve, dhe atje gjeta shoqeri ku bëja diskutime rreth fesë ku dhe mu dha rasti përmes parës së parës ta kem një Kur'an në dorën time. Herën e parë që atë e morra në dorë dridhesha pasi e mendoja si një gabim dhe mëkat. Atë mbrëmje tërë natën lutesha që Zoti të ma fal. Por përsëri si natyrë njerëzore, gjithmonë shkojmë pas asaj që na është ndaluar, dhe unë nuk e përbajta dhe e lexova atë dhe u impresionova se si që të dy Pejgamberët tonë Musa dhe Isa paqja qoftë mbi ta. Më pas vazhdova kërkimin tim nëpërmes internetit. Gjithmonë shikoja të vërtetë dhe jo të drejtë. Edhe pse pothuajse të gjithë shoqërinë e kisha musliman Suni, unë vendosa rrugën e Ehli-Bejtit e pranova Islamin Shiit. Para se të thoja shehadetin dësh-

minë i tregova familjes sime, dhe kushëritat ndaluan së foluri me mua, kurse nëna dhe babai me flisin por nuk ishin të kënaqur. Prapë se prapë e kalova dhe këtë dhe mbi të gjitha shkova në Mesxhidul Aksa në Jerusalem të Palestinës dhe dëshmova përmes qenurit muslimane tanë e tutje.

Kur u mbulova gjendja u vështirësua, pasi që u desh të largohesha nga Izraeli para se të flijohesha dhe që të mund të kthehesha në Francë. Familja nuk do më pranonin si dhe tanë më nuk kisha as punë përmes punuar. Zoti mi hapi rrugët dhe shkova në Suedi tek një shoqe. Atje ishte më e lehtë pasi që edhe shoqja ime ishte muslimane që pasonete Ehli Bejtin pra Familjen Profetike. Atje mendova se do përparoja dhe do gjeja punë mirëpo më mori 3 muaj kohë dhe nuk munda, por arrita që ta njihja fenë time maksimalisht. Dhe nuk gjeta punë prandaj u detyrova të kthehesha në Francë. Edhe në Francë nuk gjeja punë dhe vendosa që në Portugali. Atje isha përmes 4 vite, punoja dhe jetoja në xhami sunite ata më priten mirë edhe pse nuk i pata treguar çfarë drejtimi i përkisja, aty duke studiuar edhe drejtimin sunnit, shumë më shumë iu binda Profetit Muhammed (paqja qoftë mbi të dha familjen e tij) si dhe Ehli-Bejtit. Usule Dini (themellet e fesë) i mësuar nga vet profeti dhe imamët përbante 5 gjërat më të plotësuar me njëra tjeterën ku ishte edhe ADL drejtësia e Zotit që përmes sunnit ishte ajo që ishte dha nuk ndryshonte dhe kjo që kuptova në lidhje me këtë në drejtimin që kisha zgjedh më bëri të kuptoja se me të vërtet feja ime dhe Zoti im janë të përsosur dhe këto i mësova nga mësimet e Ehli Bejtit.

Gjatë studimeve të mia përmes re që e pranova, u ndala edhe në historinë islamë. Kthimi në histori më ndihmoi shumë të kuptoja se Pejgamberi Muhammed s.a.a. para se të ndërronte jetë kishte zgjedhur mëkëmbësin e tij. Dhe nuk ishte aq e thjesht sa përmes fesë Fe kaq të madhe të harrohej ashtu lehtas dhe ai Profet i përsosur dhe vula e të gjithë Profetëve të tjera ta lente fenë e fundit të Zotit pa udhëheqës pas tij. Mes muslimanëve Suni, besimi im filloj të dobësohej përmes arsyë se ata kritikonin dhe vetëm kritikonin drejtimin tim duke mos e ditur se unë isha një nga ata që ata ofendonin. Vendosa që të largohesha edhe nga aty, pasi nuk isha e qetë dhe dijenitë e tyre nuk po më flinin tek unë. Unë u ktheva atje ku e kisha thënë dëshminë time, në Mesxhidul Aksa. Jeta është e gjatë dhe e vështirë por unë jam e lumtur përmes fenë që kam.



## Poeti, Shejh Aliu rrezaton me poezi të thella mistike!



Poeti Ali Sylaj lindi në një familje besimtare në vitin 1967, në fshatin Sheremet të komunës së Gjakovës. Që nga fëmijëria mori mësimet e para fetare nga gjyshi i tij, i cili ia mësoj gjërat elementare të fesë, kurse nga e ëma mësoj përsufizmin islam dhe për Familjen Profetike (Ehli Bejtin). Nëna e mësoj që për Familjen Profetike duhet të ketë dashuri të madhe dhe respekt të thellë, gjë kjo që ju mbjell në zemër dhe ju fiksua në kokë përtër jetën. Pasi kreu shkollën fillore në vendlindje dhe gjimnazin në Gjakovë, vazhdoj studimet në fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, mirëpo gjatë tërë kohës merrej edhe me lexime të ndryshme e sidomos me literaturë fetare dhe njëherit merrej edhe me poezi, që i botonte në revista të ndryshme pastaj në disa antologji të poezisë, dhe së fundmi botoi edhe përbledhjen me poezi me titull: "Hapërim drejt përjetësisë".

Hulumtimi i vazhdueshëm mbi fenë sidomos mbi misticizmin islam dhe rendet mistike e qoj deri te takimi me udhërrëfyesin e tij shpirtërorë, ku u bë anëtar i rendit mistik Melami, dhe ku pasioni i tij përmistiken filloj të rritej dhe thellohej vazhdimisht derisa arriti të merrte edhe titullin Shejh i vllazërisë apo rendit Melami.

Shejh Aliu vazhdon të njëjti aktivitet duke ju përbajtur thënies së themeluesit të rendit: "Nuk na intereson forma dhe shfaqja e jashtme por qëllim kemi përqendrimin e mbrendshëm dhe arritjen e gnosës apo marifetit.

Aktivitetin e vazhdon kryesisht me të rinj duke ju folur vazhdimisht përsesimtin dhe vlerat e larta morale, dashurinë, bamirësinë dhe shërbimin me mirësi ndaj njerëzve që duhet t'i ketë një besimtar dhe shembull duhet pasur Profetin e bekuar dhe Familjen e tij, si dhe besimtarët e sinqertë sepse sinqueriteti është çelësi i dyerive të hakikatit.

Në këto kohë të vështira të një jete të egër mareriale dhe epshore, ku shpirtërorja vazhdimisht po zbehet, dhe shumë të rinjë po përfundojnë në kthetrat e depresionit, alkoolit, drogës, prostitucionit bile edhe vetëvrasjes, mësimet fetare dhe ringallja e besimit tek të rinjtë është e domosdoshme. Këto mësime shpirtërore zakonisht i shprehë edhe në poezitë e tij.

### Poezia

Poezia e tij është poezi mistike me tematikë nga libri i shenjtë - Kurani famëlatë, nga këshillat e Profetit të bekuar Muhamedit paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij, por edhe të profetëve tjerë, si dhe thëniet dhe veprat e imamëve të familjes profetike (Ehli Bejtit), dhe njerëzve të përndritur (eulijave). Në poezi shprehë edhe gjendja e brendshme shpirtërore (hali) që përjeton udhëtarinë rrugën e hakikatit, ku në çdo nivel të ngritisë gjërat shihen dhe përjetohen në një prizëm krejt tjetër.

- Në poezitë e tij nganjëherë shprehë edhe revoltën përpadrejtësinë dhe mizorinë që bënë paganët e mbuluar me maska besimtarësh ndaj familjes së Profetit duke ua marrë pushtetin dhe duke vrarë mizorisht familjen profetike, dhe duke devijuar muslimanët nga rruga që urdhëroj Zoti dhe Profeti i Tij, ku nga ai devijim edhe sot e kësaj dite muslimanët vuajnë pasojat dhe kanë mbetur në huti e agoni pa ditur ta gjejnë rrugën e vërtetë. Poeti bënë thirrje përsesimtin dhe dituri që lindë nga hulumtimi dhe kërkimi i së vërtetës dhe jo në imitim dhe rutinë që të lënë injorancë dhe prapambeturi.

Përgatiti : Redaksia Vlera

## Zgjoje dashurinë e fjetur

Zoti kur krijoj dashurinë, e vari pranë arshit si stoli  
Do ta vë në gjoksin e robit tim, me krijimin tënd o njeri

Dhe zgjuar ta mbash si dritë të ndezur deri në përjetësi  
Mos të të mashtrojë ziliqari, as kotja mos të rrëmbejë ty

Zgjoje dashurinë e fjetur para se dielli të ketë perënduar  
Do ndriçojë si kandil në netët e errëta me acar të tërbuar

Zemra kupë hyjnore, në të Zoti zbrazi fshehtësinë  
E gjetën ata që vrerin larguan dhe zgjuan dashurinë

Pastruan çdo kënd të saj dhe djallin e débuani  
Botës dashuri i shpérndanë, edhe pse u injoruan

Pjesë e asaj dashurie ende valëvitej në qiell si paikua  
Fati bëri të lëshohej vrik, në zemër më goditi mua

I dehur nga vera hyjnore gjithë natën vallëzova e këndova  
Të zgjuarit s'mund të flinin, të fjeturit nga gjumi i zgjova

Miqtë më pyesnin: ç'ke që sillesh në sema, o Ali  
Saku, vere shpérndarësi thashë, më magjepsi me verën e tij.





# Këshilla rreth kopshtit për fillestaret

Besoj që të gjithë kemi shijuar perime apo fruta nga kopshti dhe jemi mahnitur me shijen e ëmbël dhe të freskët të tyre. Nuk krahasohet asgjë me pemët e perimet e freskëta, veçanërisht nëse i rritni vetë në kopshtet tuaja - gjë që mund të realizohet shumë lehtë.

Më poshtë do të shtjellojmë rregullat bazë për kopshtarinë dhe mbjelljen e perimeve në shtëpi: si të zgjidhni hapësirën e duhur, si ta krijoni kopshtin me madhësinë e nevojshme dhe se cilat perime t' I rritni.

## ZGJEDHNI VENDIN E DUHUR

Përzgjedhja e lokacionit është një ndër pikat thelbësore se a do të jetë I suksesshëm kopshti juaj. Mbjellni bimët tuaja në një vend me diell. Shumica e bimëve kanë nevojë për të paktën 6 orë dritë dielli gjatë ditës. Mirëpo, ka disa bimë të cilat tolerojnë një sasi të hijës gjithashtu. Mbjellni bimët tuaja në tokë që si veçori ka largimin e menjëherëshëm te ujtit të tepert. Nëse keni dhe I cili nuk kullohet sa duhet, atëherë krijoni një kornizë druri për ta kufizuar dheun dhe mbjellni bimët. Në qoftëse toka juaj është shkëmbore, atëherë largoni guralecët dhe mbusheni hapësirën me dhe.

Shmangni vendet të cilat shërbejnë si korridore të erës pasiqë fryma mund të rrëzojë apo shkatërrojë bimët tuaja. Gjithashtu, evitojeni mbjelljen e bimëve në hapësira ku mund të grumbullohet uji.

## ZGJEDHJA E MADHËSISË SË PARCELËS: FILLONI NGA NJËSI TË VOGLA!

Mos harroni: është më mirë të jeni të kënaqur me një kopësht të vogël sesa të jeni të mërzitur më një kopësht të dështuar!

Një nga gabimet më të zakonshme që bëjnë fillestaret është mbjellja e shpëjtë e një numri të madh të bimëve. Filloni nga njësi të vogla, dhe mbjellni vetëm perimët apo frutat të cilat e dini se do t'I hani.

Ja disa këshilla për një kopësht perimesh për fillestaret me madhësi që mund të ushqejë një familje katër antarëshe

gjatë verës, dhe të ketë mbetjë për konservim apo dhe ngrirje (ose pse jo dhe t'I surprizoni fqinjët tuaj me të mbjellurat tuaja)!

Krijoni një kopësht me 11 rreshta të gjërë, me secilin rresht 4 metra të gjatë. Rreshat duhet të drejtohen nga veriu dhe jugu për të përfituar sa më shume nga diellosja. Sigurohuni që të keni shtigje që ju lejojnë të hyni në afërsi të bimëve tuaja për t'I mbjellur dhe korrur ato. Rregulli I përgjithshëm është: Mos lejoni të kaloj distancë më e madhe se 1.2m pa pasur qasje në parcelën ku keni mbjellur bimë.

## ZGJEDHNI PERIMET!

Perimet e sugjeruara më poshtë janë të zakonshme, janë bimë që prodhojnë relativisht shumë dhe janë të lehta për t'u rritur.

## TOP 10 PERIMET PËR T'I MBJELLUR NË KOPSHTIN TUAJ:

DOMATET	PANXHARI
KUNGULLESHAT	KARROTA
SPECAT	RREPA E KUQE
LAKRA	TRANGUJT
SALLATA E GJELBËRT	SPINAQI

**(BONUS)** LULET MARIGOLD PËR TË LARGUAR INSEKTET, DHE GJITHASHTU I SHTON NGJYRË KOPSHTIT TUAJ!

Zgjedhni perimet tē cilat ju dhe familia juaj I pēlqeni! Nēse askush nuk pēlqen lakeren, atēhere mos e mbjell! Jini realist se sa do tē hanē familia juaj. Kini kujdes tē mos e mbingarkoni kopshtin.

Shiqoni se cilat pemē apo perime mund t'I gjeni nē tregun tuaj mē tē afert. Nē qoftë se nē market gjithemonē gjeni karrotat, ndoshta do tē ishtë mē mirë tē mos i mbjellni ato, por tē mbjellni dička qē nuk eshtë nē dispozicion nē treg. Gjithashtu duhet marrë parasysh faktin qē disa perime shijonë mē mirë nēse janë tē rritura nē kopësht, shembulli I sallatës se gjelbert ose domateve! Një ide tjetër eshtë rritja e erëzave si magdanozi, rozmarina, borziloku, etj. nē shtëpi.

Nēqoftëse keni mbjellur perime tē cilat rriten gjate verës, shembull domatet dhe kungulleshat, gjatë kohës qe jeni me pushimë nē bregdet, ju duhet tē gjeni dikë pēr t'u kujdesur pēr kopshtin tuaj pērderisa jeni larg nga shtëpia.

menjëhere pas kalimit tē ngricave nga dimri, kurse ato tē grupit tē dyte, ne periudhën e dytë tē pranverës.

Mbillni perimet e gjata (fasulet apo misri) nē anën ve-riore tē kopshtit tuaj pēr tē mos I rënë hija bimëve tjera. Nēqoftë se keni pjesë tē cilat janë tē hijëzuara, mbillni perime tē cilat kanë nevojë pēr hije.

Shumica e perimeve janë vjetorë (tē mbjellura çdo vit). Nēse po planifikoni tē lashtat 'shumëvjeçare' tē tilli si asparagus, barishte, etj. siguron i shtretër tē pērhershëm pēr to.

Disa tē mbjellura piqen shpejtë dhe kanë pēriudhën shume tē shkurtër tē korries, (rrepka, fasulet). Bimë tē tjera si domatet, I'u duhet periudhë mē e gjatë kohore. Perimet tē cilat zgjasin mē shume se një sezoni janë: fasulet, panxhari, karrota, lakra, spinaqi, sallata e gjelber dhe rrepa.

## BLINI APO NDËRTONI NJË SERË!

Ju mund tē rritni nē mënyrë dramatike korrjen tuaj mē ndërtimin e një serë, qoftë ajo e vogël apo e madhe. Këtu janë disa arsyë se pse ia vlen investimi nē një gjë tē tillë.

## ZGJAT SEZONIN E KORRJEVE!

Të kesh një serrë do tē thotë se ju mund tē filloni mē herët me mbjelljen e fidaneve nē krahasim me mbjelljen e bimëve kur sezona vjen. Ju gjitashtu do tē jeni nē gjendje tē rritni tē lashtat tuaja si patëllxhani ose specat, gjatë verës, qē eshtë sezona kryesore e rritjes së tyre, e duke vazhduar akoma me vonë gjatë sezonit pasiqe temperaturat Brenda serrës krijojnë kushtë tē favorshme pēr vazhdimin e rritjës së këtyre bimëve.



## KU DHE KUR TĒ MBJELLIM?

Nēse do rrisni dy ose tre trupa tē domateve, ky process eshtë I lehtë. Por nēse mbillni pēr tē rritur një kopësht tē tèrë, duhet tē merrni parasysh:

KU DO TĒ PËRFUNDOJ SECILA BIMË PASI TĒ RRITE?  
NĒ ÇFARË KOHE DUHET TĒ MBJELLET?

Tē listuara keni disa udhëzime pēr mbjelljen e perimeve tuaja:

Ekzistojnë perime tē cilat rritën nē sezona tē 'freskëta' (lakra, spinaqi, dhe perimet rrëniore) dhe perimet tē cilat nuk mbillen derisa tē jëtë plotësishtë I thatë dheu (domatet, specat). Bimët e grupit tē parë duhet mbjellur



# Koha për shëndetin



## Boronica e kuqe

Përveç ndikimit shërues në traktin urinar, boronicat e kuqe shkatérrojnë bakterin Helicobacter pylori, i cili nxit të thatin në lukth dhe zvogëlojnë rrezikun nga shfaqja e sëmundjes së dhëmbëve dhe të mishit të dhëmbëve.

Frutat e boronicës së kuqe janë tepër të pasura me vitaminë C dhe me materie të tjera mbrojtëse, veç të tjerash, me bioflavonoide, të cilat kanë ndikim të fuqishëm si antioksidues, me të cilën zvogëlojnë rrezikun nga karcinoma (e gjijnje dhe e zorrës së trashë), si dhe nga sëmundjet e zemrës, sepse e rrisin përbajtjen e kolesterinës "së mirë". Boronicat e kuqe ndihmojnë edhe te përtëritja e shqisës së të parit dhe e ulin sheqerin në gjak, ndërsa janë të dobishme edhe për personat me stres.

## Kopra pengon gazrat

Kopra ndihmon që ushqimi të kalojë shpejt nëpër organizëm, me ç'rast pengon krijimin e gazrave dhe ngërçet e muskujve, që kanë për pasojë fryerjen e barkut dhe dhembjen. Për të bërë çaj, merret një lugë gjelle fara të thyera të koprës me 2 decilitra ujë të vluar dhe lihet të qëndrojë 10 minuta. Pihet tri herë në ditë pas ushqimit. Më së lehti është që gjysmë luge fara të hahen pas ushqimit.



## Mendra qetëson barkun

Çaji i mendrës ndihmon tretjen, zvogëlon turbullimin, gazrat, fryerjen, ngërçet dhe qetëson barkun e trazuar. Një lugë e gjysmë gjelle mendër qitet në 2 decilitra e gjysmë ujë të vluar. Lihet për 15 minuta, kullohet dhe përdoret menjëherë. Çaji i mendrës nuk bën të pihet nëse dhembja në bark është e shoqëruar me thartirë, sepse vajrat nga kjo bimë mund ta përkeqësojnë gjendjen.





# Dobitë e shumta të piperit të zi

Ka një arsy se pse piperi i zi konsiderohet si "mbreti i erëzave". Me shijën aromatike, përdorimin e gjërë në gatimet në kuzhinë, dhe dobitë medicinale, piperi i zi ka fituar një vend të veçantë në secilin dollap të erëzave në kuzhinë apo dhe në vendin ku mban gjérat tuaja medicinale. Që nga kohërat e lashta, piperi I zi është shfaqur në shumë praktika medicinale, përfshirë qetësimin të dhimbjeve në stomak, zvogëlimin e problemeve me mëlçi, sëmundjet e mushkërive dhe problemet e tretjes. Gjithashtu mund të përmirësoj rrjedhën e gjakut, të veprojë si një anti-depresant dhe të zvogëlojë rrezikun nga kanceri i zorrëve.

Në listën më poshtë mund të gjeni sekretet dhe dobitë që përmban piperi i zi.

**Piperi i zi ndihmon përfshirë ta mbajtur kolesterolin tuaj të ulët** – Shtoni  $\frac{1}{4}$  e lugës së çajit piper të zi në një gote me qumësht. Përzieni së bashku me pak qepë të prera imët dhe pjeni.

**Piperi i humbur peshë** – Perziemi  $\frac{1}{4}$  e lugës së çajit piper të zi në një gotë me ujë, 2 lugë lëng limoni dhe një lugë mjaltë. Përzieni mirë dhe pjeni këtë tretësirë çdo ditë.

**Piperi i zbutur ethet** – Merrni 7 ose 8 gjethë borziloku ose 3 apo 4 kokrra piper të zi dhe përtypni ato së bashku.

**Piperi i lehtësuar kollin e thatë** – Shtypni 5 ose 6 kokrra te piperit të zi dhe përzieni me mjaltë natyrale. Gëll-tisni një lugë nga kjo përzierje çdo ditë derisa të arrihet lehtësimi.

**Piperi i lehtësuar sulmet e astmës** – Ziheni 8 deri në 10 kokrra piper, 2 sytha karafili dhe 10 deri 15 gjethë borziloku në një enë me ujë. Lëreni që tretësira të ftohet përfshirë 15 minuta, kullojeni dhe shtoni 2 lugë mjaltë. Këshille: Pini me qumësht!

**Trajtimi i dhimbjeve në fyt** – Shtrydhni pak lëng limoni, shtoni pak kripë dhe piper të zi të grirë – dhe shpërlajeni fytin më këtë tretësirë.

**Piperi i trajtuar ftohjen** – Bëni pak çaj dhe shtoni 2 ose 3 kokrra piper të zi, një copë xhenxhefil dhe gjethë borziloku.

**Piperi i trajtuar ftohje kronike** – Konsumoni piper të zi së bashku me hurma.

**Piperi i lehtësuar frysëmarrjen me hundë të bllokuar**

– Përzieni në sasi të barabarta piperin e zi, kanellën, kimnonin dhe farat e karmionit. Bluajeni deri sa të bëhet në formë të pluhurit dhe merrni frysëmarrjen me hundës. Kjo do të shkaktojë teshtitje dhe do të hapë kanalet e hundës.

**Piperi i lehtësuar çdo lloj të kollitjes** – Bluani pak piper të zi dhe shtoni sheqer. Konsumoni përzierjen me gjalpë.

**Piperi i lehtësuar kollitjen e rendë** – Shtoni 2 ose 3 kokrra piper të zi në një gotë qumësht të nxehë të zier, prisni që të ftohet pak dhe më pas pjeni.

**Trajtimi i dhimbjes së dhëmbit** – Përzieni piperin e zi të bluar me vaj karafili. Vendosni vajin në zonën me dhimbje.

**Piperi i trajtuar problemet metabolike** – Përzieni pak piper të zi me lëng xhenxhefil dhe pjeni pas çdo vakti.

**Lehtësoni marramendjen** – Përzieni piperin e zi dhe ujin në një gotë, shtoni pak lëng limoni të freskët, përzieni dhe pjeni ngadalë.

**Trajtimi i problemeve me lëkurë** – Përgatitni një krem nga piperi i zi i grirë dhe i rafinuar në gjalpë. Aplikoni në lëkurën tuaj në qofë se keni skuqje nga alergjite e ndryshme, ekzemë apo zgjebë.

**Piperi i luftuar rënien e flokëve** – Bëni një pastë të trashë nga piperi i zi dhe farat e limonit. Aplikojeni çdo ditë në zonat kritike rrëth 10 minuta para dushit. Kjo pastë duhet të ndihmojë në gjallërimin e rritjes së flokëve.

**Piperi i trajtuar hemorroidet** – Bluani së bashku 20 gram piper të zi, 10 gram kumin dhe 15 gram sheqer. Përzieni në ujë dhe pjeni çdo mëngjes.

**Piperi i ndaluar gjakderdhjen** – Mbuloni plagën më piper të zi të grirë. Vendosni fashën dhe shtrengojeni mire plagën. Prisni 10 minuta dhe gjakderdhja do të ndalet.

**Piperi i ndaluar lemjën** – Mbajeni një pjatë të vogël me piper të zi afër hundës, merrni frysëmarrjen me hundës. Kjo do të pushojë lemjën.



# Veprat kulturore dhe bamirëse prekin vlerat e larta njerëzore

Instituti "Naim Frashëri" në Prishtinë për nder të ditëlindjes dhe veprimtarisë së shkrimtarit Naim Frashërit, sot ka zgjedhur të jetë pranë fëmijëve në SOS fshat duke iu dhuruar një përkrahje modeste me gjëra ushqimore dhe veshje për 60 fëmijë. Në kuadër të projektit "Qyteti Urban me Fraza Naimijane" i aproriuar nga Drejtoria e Kulturës - Komuna e Prishtinës, u shpérndan edhe broshura me fraza inkurajuese nga figura e shquar e Naim Frashërit që kishin për qëllim të njoftohen më shumë dhe më mirë për veprimtarin e poetit, shkrimtarit dhe erudit shqiptarë.

SOS fshatin në Prishtinë e vizituan stafi i Institutit Namin Frashëri, ku drejtoresha Ikballe Berisha Huduti informoi për aktivitetet kulturore dhe humanitare të Institutit si dhe ofroi një bashkëpunim të mëtutjeshëm në këto dy fusha. Kësaj radhe në këtë aktivitet janë pjesëmarrës edhe "Federata Botërore" (World Federation) nga Londra të cilën kanë ndihmuar me dhuratat humanitare, ushqim dhe veshje ndërsa Institut ka realizuar në pjesë të projektit duke dhuruar broshura me fraza inkurajuese, ndërsa pjesa e tjeter e projektit është në vazhdimësi të zhvillimit të aktivitetit.

Falënderojmë Drejtoreshën e SOS fshatit në Prishtinë znj. Ora Bytyçi e cila ndau disa informacione që përbledhin punën që ky komunitet kryen, punë kjo me virtyte të larta njerëzore. SOS fshati ofron kushtet e sigurta dhe të ngrohta bashkë me SOS nënët të cilat kryejnë punën e tyre me përkushtim të lartë ndaj fëmijëve të këtij institucioni. Ishte kënaqësi të dëgjosh rrjedhën dhe organizimin aq detajist nga stafi i SOS fshatit për fëmijët të cilët kanë humbur kujdesin prindëror/familjar.

## Kush është Institut Kërkimor Ndërkombëtar "Naim Frashëri" ?

Vizioni ynë është që të ndërtojmë një shoqëri me humanizëm dhe drejtësi, liri dhe respekt për diversitetin, si dhe barazi dhe unitet për të mirën e përbashkët të njerëzisë. Institut i mbështet materialist dhe moralist studentët dhe intelektualët e rinj përmes zhvillimit të tyre profesional, që të nesërmen të janë në shërbim të shoqërisë me ekspertizat e tyre.

Redaksia VLERA



# Dhurata e Ramazanit

## gëzon shumë familje kosovare



Organizata e quajtur "World Federation" – "Federata Botërore" me seli në Londër është dorë e lirë për punë të mira si në Kosovë , rajon dhe shumë vende të botës. WORLD FEDERATION është OJQ me status Special Konsultativ me Këshillin Ekonomik dhe Social ( ECOSOC) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

WF-AID që nga viti 1976 janë përpjekur të jetojnë me moton " Ne ekzistojmë që t'ju shërbejmë" Fillimisht përpjekjet e WF-AID u përqendruan në Lindje ku ishte më urgjente nevoja për të zbutur varférinë e popullit. WF-AID ka punuar për të ndërtuar komplekset e strehimit, shkollat, xhamitë, kishat, sallat dhe kampet mjek-sore për të ofruar njerëzve një stabilitet në jetën e tyre. Gjatë viteve. WF-AID ka ndihmuar në edukimin e 25.000 fëmijëve në botë.

### WF-AID & KOSOVA

Sa i përket aktivitetave humane në Kosovë WF ka përzgjedhur Institutin Kërkimor Ndërkombëtarë " Naim

Frashëri" i cili posedon – Departamentin për Zhvillim Social ( DZHS). si partner të sinqertë dhe si urë lidhëse e shërbimit për t'ia zgjatur dorën e bamiresisë edhe popullit të KOSOVËS:

Në kuadër të Projektit " Dhurata e Ramazanit! këtë javë janë ndihmuar qindra familje kosovare të komuniteteve të ndryshme nëpër disa qytete si Prishtinë, Prizren , Gjakovë , Suharekë , Gjilan , Mitrovicë etj.

Ndihma që i jepet nevojtarëve, miqve dhe anëtarëve të Institut Naim Frashëri ka për qëllim ë ti ruaj vlerat dinitoze të të varfërve. Ndihma është ofruar pemës kuponave në vlera të ndryshme në bazë të numrit të anëtarëve të atyre familjeve 20/30/50 euro. Ndërsa komuniteti RAE ne Gjakovë janë ndihmuar me 300 pako ushqimore me vlerë nga 20 Euro.

*Në vazhdimësi pritet te vazhdojmë bashkëpunimin edhe për aktivitetet e tjera*



# *Urime ditëlindjen i madhi Imam Riza.*

E gëzofshin sot e për shumë mot, muslimanët anë mbanë nëpër botë.

